

DI
DRITA ISLAME



ISLAMI

feja e përsosur



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 08 (483)
Gusht, 2023

ISSN 2226-7115




Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Islami, feja e përsosur / Mehmet Disha
- 8 Smira, kjo brejtëse e imanit / Dorian Demetja
- 10 Lajme / Aktivitete



- 14 Kur’ani, udhëheqje shpirtërore për të gjithë / Ismail H. Muçej
- 18 Njohja e Zotit / Ramazan Fetahu
- 20 Profeti ynë cakton mësues, që të shkonin nëpër qyteza të ndryshme dhe t’u mësonin njerëzve islamit / M. Jusuf Kandeheui
- 22 Njeri, je gjëja më e bukur e kësaj bote / Dr. Aid el Kamij
- 24 Reagim / Redakcia
- 26 Mosmirënjohësit / Nuredin Nazarko
- 28 Këshillat e filozofëve / Retrospektivë



- 30 Imam Sahit Hoxha (1898-1973) / Personalitet
- 32 Moringa: Një burim shërimi / Omer Yildiz
- 34 Shpeshhtësia e të ngrënit dhe shembulli i profetit Muhamed a.s. / Sinem Akbulak
- 36 Një martesë e shëndetshme, një investim i çmuar / Aisa Kokiçi
- 38 Plaku thinjosh / Saimir Lleshi



Islami **feja e përsosur**



Islami është emërtimi dhe cilësia e një përmbledhjeje vlerash të përkryera e të pareduktueshme, pa kurrfarë të mete a mangësie, e cila do t'i përgjigjej çdo nevojë të çdo shoqërie që ka ardhur dhe do të vijë mbi rruzull gjer në kiamet. Për rrjedhojë, kush bën pjesë në këtë fe duhet të jetë pandërprerë në kërkim të përsosurisë dhe plotërisë, me një fjalë, të asaj ç'është e përkryer e që nuk ka as të metën më të vogël. Nëse do të shpreheshim më thjesht, pjesëtarët e fesë së fundit, e cila është kryer e plotë dhe e përsosur, në qoftë se duan që t'i arrijnë synimet e bukura dhe të mbara që parashtron ajo, do të thotë se duhet të ngarendin për t'i sendërtuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrën më të plotë e sa më të përkryer. Siç kuptohet edhe prej përmbajtjes së qartë të këtij ajeti, kjo është edhe rruga për të ecur drejt horizontit të kënaqësisë hyjnore.¹

"Bjerrjet dhe dështimet qenë për fajin tim"

Ndërsa po të vijmë tek kushtet për të arritur tek ky horizont; kushti i parë për të realizuar qëllimin e treguar prej ajetit fisnik, është të jesh i vendosur e t'i kesh vënë vetes qëllimin, që ato mundësi dhe aftësi që të ka falur Allahu (xh.xh.) t'i përdorësh në mënyrën më të frytshme të mundshme. Për shembull, dikush ka zë mjaft të bukur; dikush tjetër ka aftësi marramendëse për punë të caktuara, ta zëmë, di t'i organizojë dhe t'i ngarkojë njerëzit me detyrat e duhura; dikush tjetër mund të ketë një penë shumë të mirë; dikush tjetër mund të ketë aftësi tejet të mira për të folur bukur. Cilido, ciladoqoftë aftësia që zotëron duhet të përpiket që t'i përdorë në mënyrë sa më të frytshme gjer në pikën e fundit të tyre në emër të shprehjes të së drejtës dhe të vërtetës; kësisoj edhe nëse në pah dalin një sërë gabimesh a të metash, në vend që gabuesi a fajtori të kërkohet jashtë vetes, duhet t'i dish ato prej vetes, duke nisur menjëherë nga përpjekja për t'i ndrequr.

Veçanërisht ata që ia kanë dedikuar veten shërbimit të besimit dhe Kuranit, le të jenë të ngarkuar me detyrë në cilëndo prej aspekteve të jetës shoqërore, duhet ta shohin secili veten si përgjegjës në rast të mosarritjes dot të përsosurisë dhe plotërisë në punët e bëra, e kësisoj edhe të metat t'i dinë prej vetes. Sepse, në thelb, mendimi i gjithsecilit syresh, se "*nuk arrita dot që t'i kryeja siç duhej detyrat që më ishin ngarkuar mbi supe, madje nuk arrita dot ta përfundoja, edhe pse vazhdimisht merrja*

fryte prej saj; ja, kjo punë shkoi dëm pikërisht prej të metave të mia", nuk është tjetër por një pendim i vetvetishëm, madje sipas gjerësisë së zemrës, mund të quhet edhe një rikthim tek Allahu apo një dimension akoma edhe më i thellë i pendesës, që është t'i kërkosh Allahut mbrojtje prej çdo lloj shkarjeje prej rrugës së drejtë. Dhe Allahu (xh.xh.) i përgjigjet me mirësitë dhe ndihmesën e Tij kësaj zemre të këtillë, që vuan, duke ia çuar akoma edhe më përpara punët me ndihmesën e Tij shtesë.

Në të kundërt, nëse ndokush i sheh përherë si të përkryera punët që bën vetë, duke besuar se në punët që ai kryen nuk mund të gjendet kurrfarë e mete, madje duke menduar sikur planet dhe projektet e tij janë aq të patëmeta, sa do të mund të ngadhënjenin edhe mbi qiellin, i cili për çdo bluf ua vë fajin atyre që nuk e dëgjuan, nuk e kuptuan dhe nuk iu bindën asohere, nuk është tjetër pos një tjetër trajtë e vetëmashtrimit të faraonit, që tha: "*Unë jam Zoti juaj më i madh!*"² Madje, njeriu duhet ta kryejë vetëgjykimin e egos së tij përballë gabimeve apo dështimeve lidhur paksa përpjesëtueshëm me punën në krye të së cilës ndodhet. Me një fjalë, sa më e rëndë të jetë detyra e tij, aq më i ashpër duhet të jetë edhe kërkimi i llogarisë ndaj vetes. Domethënë, sa më shumë që shtohen institucionet e ndërvarura për të cilat është përgjegjës, ai duhet t'ia atribuojë vetes çdo mangësi apo dështim të ndonjërit syresh. Ai duhet të mendojë se të gjitha këto përfundime jopozitive, rrëzime a dështime burojnë prej një sërë mangësish të tij, siç mund të jetë ajo e mosmbajtjes së një lidhjeje të shëndoshë me Allahun (xh.sh.), nga mosndijimi aq thellë sa duhet i Islamit, nga mosinterpretimi i drejtë i parimeve të mrekullueshme të Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), nga mosleximi siç duhet i kohës dhe kushteve të veprimit dhe nga mosnjohja mjaftueshëm e anës kundërshtarë.

Bukuritë janë të Tijat, mangësitë dhe të metat janë tonat

Megjithëse, ky parim i qartë i Kuranit Fisnik në lidhje me këtë çështje, nuk të lë nevojë për shumë fjalë: "*Çdo fatkeqësi që ju ndodh vjen për shkak të asaj çfarë keni bërë me duart tuaja. Allahu jua fal më të shumtat.*"³ E shpreh vetë Kurani, se si gabimet dhe boshllëqet e ndryshme dalin në pah si pasojë e një vështrimi të syrit, një dëgjimi të veshit, një arsyetimi të mendjes, një fjale të gjuhës,

2. Naziat, 79/24

3. Shura, 42/30

1. Maide, 5/3

një prekjeje të dorës, një hedhjeje të hapit apo ndijimi nëpërmjet ndjenjave përkundër qëllimit të tyre të krijimit, dhe se si Allahu (xh. sh.) i fal shumicën e tyre. Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në hadithin e Tij, "*Çdo bir i Ademit gabon. Por më të mbarët ndër ata që gabojnë, janë ata që pendohen më shumë.*"⁴ përpiket të na kujtojë se njeriu i ka të ngërthyer brenda vetes ndjesitë dhe ndjenjat për të gabuar, me pak fjalë e ka në natyrë gabimin. Kështu, më e rëndësishmja është që njeriu ta kuptojë gabimin dhe të përpiket për ta shlyer atë. Edhe kalifët e mëdhenj e kanë gjykuar vazhdimisht veten për hapat e hedhur, madje vende-vende edhe kanë thënë: "Ah sikur të mos e kisha bërë kështu këtë punë, por të kisha vepruar ndryshe."⁵ për të shprehur, sipas botëkuptimit të tyre, gabimet në veprimet e tyre.

Ta lexosh siç duhet gjuhën e ngjarjeve

Madje, njeriu duhet t'i dijë prej vetes të gjitha belatë dhe fatkeqësitë që mund t'i ndodhin, edhe nëse për nga mënyra se si kanë ndodhur mund të mos kenë kurrfarë lidhjeje me qëllimet apo vullnetin e tij. Për shembull, sikur edhe gjilpërën që mund t'i ngulet në këmbë teksa ecën, ai nuk duhet ta shohë si një ndodhi të rastësishme, por si një pasojë e mangësive apo të metave të tij. Si shembull për këtë gjendje, do të doja të tregoja një ndodhi: "*Një shokut tuaj i duhet që të bëjë dy, e nganjëherë edhe tri, gjilpëra insuline në ditë. Nëse në ndonjërin prej rasteve këllëfi i gjilpërës i bie nga dora, këtë e lidh drejt e me harresën e tij për të thënë "Bismil'lah!", dhe thotë: "O Zot! Po ta kisha nisur me emrin Tënd, nuk do të më kishte rënë kurrsesi. Po ashtu, nëse ndonjëherë tjetër i qëllon që ta ngulë gjilpërën mbi ndonjë shtresë muskulore, apo mbi kapilarë, e aty fillon të dalë gjak, ai ia vë fajin gjithnjë vetes për faj të ndonjë vetëmashtrimi të brendshëm, ose sepse nuk ka arritur dot pjekurinë e duhur në mendim, apo edhe se nuk ka arritur të ruajë dot ekuilibrin në sjelljen e tij."*

Për mendimin tim, ja ky duhet të jetë qëndrimi që gjithsecili duhet të mbajë përballë gjendjeve të papëlqyeshme apo fatkeqësive me të cilat mund të ndeshet. Pasi, nëse njeriu nuk do ta dijë prej vetes mangësinë apo dobësinë në lidhje me një boshllëk të dalë në pah, e nëse nuk do të gjykojë të parën veten e tij për të, atëherë nuk do të mund të shpëtojë dot prej një keqpandehjeje të përhershme ndaj të tjerëve

4. Tirmidhi, kiamet, 49; Ibni Maxhe, zuhd, 30

5. Për Ebu Bekrin e nderuar (r.a.) shihni: et-Taberani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, 1/62

dhe fajësimi të vazhdueshëm të tyre. Aq sa, ai fillon të mendojë se janë njerëzit përreth tij që po ia çojnë ters sjelljet dhe qëndrimet e tij pozitive, e kështu po ia vënë në rrezik të gjitha nismat. E medoemos, për aq kohë sa nuk do t'i vërejë dot mangësitë e veta, nuk do të ketë ndonjëherë as mundësinë për t'i ndrequr ato.

Kur, ai që i sheh dhe është i vetëdijshëm për të metat e veta, me t'u përballur me një situatë të pakëndshme, ai do të mendohet mirë e mirë, duke u orvatur që të gjejë zgjidhjet e mundshme alternative për të mos rënë sërish më në të njëjtin gabim. Po, ai njeri, që ia njeh vetes të gjitha dështimet apo mosarritjet, do të vazhdojë të ecë përherë i prirë nga arsyetimi për t'i shpëtuar rënies edhe njëherë në të njëjtin kurth, duke u mësuar që t'ia nisë çdo punë duke marrë gjithë masat e nevojshme. Për shembull, një drejtues që merret me caktimin dhe ngarkimin me detyrë të vartësve të tij, kur të vërejë se mes tyre dalin në pah mosmarrëveshje të çfarëdolloj natyre qofshin, do të përpiket të nxjerrë mësim prej kësaj, e kështu, që të mos përsëriten më të njëjtat situata, do të shqyrtojë të gjitha mundësitë, e për çdonjërin prej tyre do të përpiket të prodhojë një rrugëzgjidhje sa më të arsyeshme. Me një fjalë, në të gjitha planet e projektet e tij paraprake do të gjenden edhe zgjidhje alternative ndaj problematikash nga më të ndryshmet.

Këshillimi me mendimin e përgjithshëm

Një tjetër disiplinë tejet e rëndësishme që i ruan njerëzit prej gabimeve dhe që i ndihmon t'i kryejnë punë e tyre duke synuar përherë plotërinë dhe përsosmërinë, është këshillimi me mendimin e përgjithshëm. Mbreti i fjalës (s.a.s.) është shprehur mjaft qartë, se "*kush këshillohet, nuk del asnjëherë i humbur.*"⁶ Dhe mendoni, që edhe vetë Profeti ynë i nderuar (s.a.s.), i cili ishte i nderuar me revelatën hyjnore dhe kishte mundësinë e komunikimit me botët e përtejqiejve, e zgjidhte çdo problem duke u këshilluar më së pari me sahabët e Tij. Dhe këshillohej pikërisht me ata njerëz, të cilëve u mësonte se ç'ishte feja, cila ishte e drejta dhe e vërteta. Po, e linte mënjane epërsinë e tij absolute ndaj të tjerëve dhe sikur një njeri mes njerëzve, diskutonte me sahabët e Tij çdo problem që mund t'u kishte dalë. Kur, për Profetin e profetëve (s.a.s.) as që mund të bëhet fjalë që të gabohej për ndonjë gjë. Atëherë, edhe për ne, që jemi

6. et-Taberani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, 6/365

njerëz kaq të dobët, e kaq të prirur për të gabuar, rruga për t'i reduktuar sa më shumë rrugët e gabimit është këshillimi me mendimin e përgjithshëm.

Në ditët e sotme gjendemi përballë aq shumë spirale problematikash, qoftë si individë, qoftë si shoqëri. Nëse ju nuk e vini në përdorim sot këshillimin, që është mekanizmi më i mirë përballë problemeve më të pazgjithshme në dukje, e nuk merrni edhe mendimin e përgjithshëm, atëherë ekziston rreziku që të shtypeni nën peshën e gabimeve të njëpasnjëshme, mandej hyni në kthetrat e një psikologjie të fajit, kërkoni ngado rreth vetes veç fajtorë, e kështu nuk lini asnjë zemër të pathyer dhe asnjë njeri të pa hidhëruar me ju. Duke qenë se faji dhe gabimi është juaji, duke i fajësuar vazhdimisht të tjerët rreth jush, i largoni dhe i humbisni ata. Mirëpo, këshilla e poetit që këndonte vargjet: *"As malli as shteti të përjetshëm nuk janë, as ar e argjëndi / të ringresh një zemër të thyer është arti m'i rëndi."*

Sikur ari dhe argjëndi të ishin të përjetshëm për

ndokënd, ato do t'i kishin vlejtur në radhë të parë Karunit. Por edhe ai u zhyt në fund të dheut me tërë pasuritë dhe thesaret që zotëronte. Nuk mbeti me kaq, por siç mallkohet në Kuranin Famëlartë, është i dënuar që të zhytet vazhdimisht në fund të dheut, moralisht kësaj here, prej tërë njerëzimit.⁷ Nga ky këndvështrim, nëse ka ndonjë zemër të thyer, art dhe marifet i vërtetë është ta ringresh e ta rigjallërosh dhe njëherë. Edhe Junus Emreja, si shprehet: *"Ne nuk erdhëm t'jua thyejmë zemrat, por t'u japim jetë."* Ndaj, edhe detyra jonë është t'u japim jetë zemrave të njerëzve. E duke qenë kjo e vërteta, nëse ndokush ngrihet dhe përpiqet t'ua ngarkojë të tjerëve të metat dhe gabimet e veta, duke i fajësuar dhe duke ua thyer zemrat, atëherë duhet ta dijë se kjo është diçka e papranueshme.

Mehmet Disha

7. Shih: Kasas, 28/76-83

Smira

kjo brejtëse e imanit

Profeti Muhamed a.s. thotë: *"Në një zemër nuk mund të gjenden së bashku edhe besimi (imani), edhe smira (hasedi)."*¹

Smira në fjalor është ndjenjë e lakmisë dhe e keqdashjes, që ngjallet kur shohim dikë më mirë se veten. Në kuptimin fetar, smira (hasedi) ka kuptimin e të ushqyerit të dëshirës që një njeri të humbasë diçka të vlefshme që posedon.

Dijetarët myslimanë e kanë kategorizuar kështu këtë ndjenjë që buron nga zemra e njeriut: smirë, ambicie dhe konkurrencë. Smira është një ndjenjë, që e bën zemrën të digjet nga lakmia dhe urrejtja për t'i parë të mirat e privilegjet e dikujt të shuhen përfundimisht. Ambicia është kur uron dhe përpiqesh që të mirat e privilegjet e ngjashme të dikujt, t'i kesh edhe ti, pa u privuar tjetri nga ato. Ndërsa konkurrenca, është kur garon me bamirësit në veprat e mira.

Kur'ani e paraqet smirën si një sjellje të dëmshme dhe burim të keqeje, prej së cilës duhet të kërkohet mbrojtjen e Allahut. Abdullah ibnu Abasi tregon se i dërguari i Zotit, u këndonte suren Felek dhe Nas dy nipave të tij, Hasanit dhe Husejnit. Ndërsa në një ajet urdhërohet kështu: "A i kanë smirë ata njerëz për atë që Allahu u ka dhuruar prej mirësive të Veta? Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit librin e urtësinë dhe u patëm siguruar pushtet të madh."²

Smira nganjëherë trazohet me ambicie, ndërsa ambicia është një anë e pranueshme te njeriu. Nëse ambicia kthehet në sëmundje dhe trazohet me inat, lind smirën. Profeti ynë (paqja qoftë mbi të!), duke tërhequr vëmendjen te ky dallim mes smirës dhe ambicies, ka thënë: "Besimtari admiron, hipokriti ushqen smirë."

Në thënien e sipërcituar Profeti a.s. e shpreh qartë që smira është e kundërta e besimit dhe kundërshtarë e tij. Por mund të ndodhë që edhe një besimtar të ketë zili dhe smirë. Sepse është në natyrën e njeriut që të mos ndihet mirë kur sheh që të tjerët kanë dhe ai jo. Por e rëndësishme këtu është që këto ndjenja të kalojnë tangjent në mendim dhe të mos nguliten në karakterin e në natyrën e njeriut. Imam Gazali thotë: "Edhe pse është ziliqar, besimtari kurrë nuk do e ndërmerre hapin për ta privuar tjetrin nga të mirat dhe privilegjet, nëse e ka në dorë diçka të tillë, sepse besimtarin e kontrollon dhe e orienton besimi në Zot, si dhe vlerat në të cilat beson."

Smira në vetvete, është një sëmundje e ulët, sidomos kur kalon cakun e mendimit dhe veprohet sipas saj. Smira është sjellja e atyre shpirtave të mjerë e zemërgushtë që në vend që të kërkojnë prej thesarit të Allahut, i gëzohen humbjes së asaj që ka një tjetër në zotërim. Pothuajse pas të gjitha të këqjave që shoqërojnë shoqërinë njerëzore si: lufta, dhuna, shpifja, kaosi, vrasja, shthurja etj., qëndron e fshehur smira. Edhe ndër arsyt kryesore të kundërshtimit e të mohimit ndaj Profetëve, sipas Kur'anit Fisnik, qëndron smira. "Shumë nga ithtarët e librit, prej zilisë që kanë në

1. Nesai (sahih)

2. Nisa, 54



vete, dëshirojnë që t'ju kthejnë nga besimi në mosbesim, tani që e vërteta është e qartë për ata.”³

Bediuzzaman Said Nursi, në lidhje me smirën shprehet kështu: “Vëllezërit e mi! Në punën tonë, drejtimi më i rrezikshëm i egoizmit është smira. Nëse puna nuk është veç për hir të Allahut, zilia ndërhyr dhe e prish. Sikurse te njeriu ku dora nuk e ka smirë dorën tjetër, syri nuk e ka smirë veshin, sikurse zemra nuk garon me mendjen, edhe në qenien shpirtërore të bashkimit tonë, secili prej jush është në pozitën e një ndjenje, të një gjymtyre. Detyra juaj morale e shpirtërore nuk është që të keni zili njëri-tjetrit, por që të krenoheni me vlerat e njëri-tjetrit, që t'u gëzoheni atyre.”

Në jetën e amshuar, Allahu, duke u dhuruar banorëve të Parajsës mirësi që syri nuk i ka parë, që veshi nuk i ka dëgjuar e që biri i njeriut nuk i ka imagjinuar as në ëndërr, do t'u bëjë një dhuratë edhe më të madhe, siç është çrrënjësja dhe zhdukja prej tyre e ndjenjës së lakmisë dhe smirës. Kur'ani e shpreh kështu këtë të vërtetë: “(Në Parajsë) Ne nga zemrat e tyre ua kemi shkukur smirën.”⁴ Mbështetur në rregullin “shpërblimi është sipas llojit të punës”, sikurse në jetën e kësaj bote, edhe në jetën e përjetshme, njeriu do të shpërblehet sipas vështirësive e brengave që ka hequr, duke iu dhuruar kësaj radhe një jetë pa vështirësi e brenga. Sikurse uria dhe etja në këtë botë kanë si përfundim një jetë pa uri dhe etje në jetën

e amshuar, po ashtu, njeriu që ka kapërcyer vetveten duke luftuar kundër ndjenjave e pasioneve që janë quajtur “sëmundje të zemrës”, do të shpërblehet duke u çliruar përgjithmonë prej tyre në jetën e amshuar.

Smirëzëiu nuk gjen qetësi dhe nuk e shijon jetën, derisa t'i shohë të mirat e personit që urren, të shuara. Është për të ardhur keq që lakmia dhe smira të përhapen kaq shumë mes njerëzve të afërm, mes kolegëve të punës, në familje, mes komshinjve etj. Kjo është kaq e rrezikshme, sa edhe veprat e mira i përpin ashtu si zjarri drutë. Në lidhje me të Profeti ynë (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ju bëj thirrje të shmangeni prej smirës, sepse smira i shfaros veprat e mira të njeriut siç i shfaros zjarri drutë.”⁵

Nëse zemra nuk ushqehet me bindje dhe dashuri për Allahun, atëherë tek ajo do të mbizotërojë smira, urrejtja, lakmia e të tjera si këto. Këtë nënkupton edhe Profeti ynë kur shprehet: “Në trup gjendet një copë mishi. Nëse ajo është mirë (e shëndoshë), i gjithë trupi është mirë, nëse ajo është e prishur (e sëmurë), i gjithë trupi është i prishur. Kjo copë mishi është zemra.”⁶

Dorian Demetja

3. Bekare, 109

4. Araf, 43

5. Ebu Daudi, Ibn Maxhe

6. Buhariu, Muslimi



1

VIZITA E ZËVENDËS AMBASADORIT TË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti me datë 07. 07. 2023 në një takim pune në selinë e institucionit, z. Abdullah Al Shahri, Zëvendës Ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u fokusua kryesisht në mbarëvajtjen dhe përmbylljen e ritualit të haxhit për këtë vit, ku si asnjëherë më parë, nga Shqipëria u nisën mbi 800 besimtarë.

Një pikë tjetër ishte edhe diskutimi mbi bashkëpunimet dhe marrëdhëniet e mira institucionale ndërmjet Ambasadës dhe KMSH-së. Takimi vijoi më tej në formën e një bashkëbisedimi të lirë rreth aktualitetit të vendit.





2

CEREMONIA E DIPLOMIT TË STUDENTËVE TË PROGRAMIT 1 VJEÇAR NGA INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI"

Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, me datë 08.07.2023, zhvilloi në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër", ceremoninë e diplomimit të studentëve të programit 1 vjeçar për formim të përgjithshëm fetar.

Ky trajnim synoi t'u ofronte studentëve njohuritë bazë fetare në lëndët Kuran, Hadith, Tefsir, Fikh, Akaid, Histori Islame, etj.

Në këtë ceremoni, ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari i KMSH-së e njëkohësisht koordinatori i institutit, z. Taulant Bica, Kryetari i Bordit të Adimstrimit të KU "Bedër", z. Ali Zaimi, Drejtori i Kulturës dhe ai i Arsimit në KMSH, z. Dorian Demetja dhe z. Elton Karaj, si dhe myftinj, imamë, pedagogë dhe studentët që u bënë pjesë e këtij trajnimi përgjatë gjithë vitit që lamë pas.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu, pasi uroi studentët për përfundimin me sukses të këtij programi, falenderoi të gjithë organizatorët për angazhimin dhe punën në këtë kontekst. Më tej, ai i siguroi ata për mbështetje të vazhdueshme institucionale në lidhje me aktivitetin në vazhdim.

Studentët i përshëndetën gjithashtu Nënkryetari Bica, z. Zaimi, z. Demetja, z. Karaj, Myftiu i Peshkopisë, z. Muis Kurtulla dhe ai i Vorës, z. Baftjar Këllëzi. Në fjalët e tyre, ata shprehën vlerësim të lartë për studentët pjesëmarrës dhe ju uruan atyre suksese në praktikimin e këtyre dijeve të marra përgjatë gjithë trajnimit.

Më pas, studentët e diplomuar nga ky vit u pajisën me certifikatat përkatëse, certifikata të cilat ua dorëzoi personalisht Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu.

Në vitin e tij të dytë të aktivitetit, Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", diplomoi 36 studentë, djem dhe vajza. Kujtojmë se vitin e kaluar ishin 40 të tillë.





3

VIZITË LAMTUMIRE E AMBASADORIT GJERMAN NË TIRANË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim lamtumire Ambasadorin Gjerman në Tiranë, z. Peter Zingraf.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetari Spahiu i shprehu atij vlerësim për bashkëpunimin e frytshëm që ka karakterizuar marrëdhënien ndërmejt dy institucioneve gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në vendin tonë, si dhe i uroi atij suksese në angazhimet e ardhshme.

Ndërsa Ambasadori Zingraf, pasi shprehu kënaqësinë e përbushjes së misionit të tij diplomatik në vendin tonë, vlerësoi edhe njëherë rolin e KMSH-së në ruajtjen dhe promovimin e harmonisë dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri.

Gjatë kësaj vizite, Ambasadori Zingraf shoqërohej nga zv. Ambasadori, z. Thilo Schroeter.





4

VIZITË E AMBASADORIT TË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me datë 25.07.2023 priti në një takim në selinë e KMSH-së, Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Faisal Ghazi Hifzi.

Kjo vizitë e Ambasadorit vjen në kuadër të vigjiljes së pjesëmarrjes së kryetarit Spahiu në konferencën islame ndërkombëtare që do të mbahet në mesin e muajit të ardhshëm në Mekë, ku z. Spahiu është i ftuar nga Ministri për Çështjet Fetare në Arabinë Saudite, Abdul-Latif bin Abdul-Aziz Al Shejkh.

Pas diskutimit mbi detajet e kësaj konference, takimi ndërmjet palëve vijoi në formën e një bashkëbisedimi të lirë mbi bashkëpunimin e ndërsjellë institucional në shërbim të së mirës së përbashkët që ka karakterizuar deri më tani marrëdhënien ndërmjet KMSH-së dhe Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë.

Të pranishëm në këtë takim ishin gjithashtu edhe Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe Këshilltari i Kryetarit për Botën Arabe, Prof. Xhemal Saferty.



Kur'ani

UDHËHEQJE SHPIRTËRORE
PËR TË GJITHË



Kur njeriu planifikon për të bërë një udhëtim për në një shtet tjetër, së pari shikon hartën për të marrë udhëzimet e nevojshme, në mënyrë që të arrijë i sigurt në destinacion. Po kështu edhe myslimanët duhet ta konsiderojnë jetën si një rrugë për t'u ndërmarrë prej tyre. Çdonjëri nga ne është në një pikë në mes lindjes e vdekjes dhe të gjithë jemi në rrugën në mes krijimit e gjykimit, prandaj për këtë kemi nevojë për një hartë udhëzuese, një hartë që të na njohë e të na udhëzojë se në ç'drejtim duhet të udhëtojmë për të arritur në destinacion shëndoshë e mirë. Është vetëm udhëheqja hyjnore që na e tregon këtë rrugë të drejtë.

Përse duhet ta kemi këtë e jo diçka tjetër? Jeta është me shumë probleme të vështira; për ta përshkruar atë kemi nevojë për ndihmë. Qëllimi ynë final në jetë nuk është kalimi nëpër të, por përmbushja e disa detyrimeve, sa të jemi në këtë tokë, dhe kthimi te Zoti, "destinacioni" ynë në jetën pas vdekjes.

Përse duhet të ndjekim udhëheqjen hyjnore? Kur u pyet Daniel Webster se cili është mendimi më sublim që i shkonte nëpër mend, ai u përgjigj: "Përgjegjësia ndaj Zotit". E pra, ne jemi përgjegjës para Zotit për sjelljet e veprimet tona në këtë jetë. Jeta jonë mund të zgjasë nga pesë minuta e deri në disa vite apo disa dekada, por gjatë saj ne duhet të kemi parasysh përgjegjësinë ndaj vetes e familjes, shoqërisë e mbi të gjitha ndaj Zotit. Me zgjuarsinë e pafund dhe me mëshirën e plotë që Zoti ka, i ka komunikuar njeriut udhëzimet e Veta nëpërmjet profetëve në kohë të ndryshme. Urdhrat zbatuese të Tij kanë për qëllim që ta mbrojnë njeriun në këtë jetë të përkohshme nga të këqijat që herë pas here shfaqen dhe ta kthejnë të sigurt tek Ai në jetën pas vdekjes. Zoti në këtë mënyrë udhëhoqi Ibrahimin, Teuratin ia dërgoi Musait, Zeburin Daudit, Ungjillin Isait dhe Kur'anin Muhamedit a.s.

Kështu pra, Kur'ani është si një hartë rruge për të na udhëhequr me qëllim që të përmbushim detyrat e qëndrimit tonë në këtë jetë dhe për të fituar një vend të ndriçuar në jetën e pasosur.

Ç'është Kur'ani? Kur'ani është fjala e

fundit e Zotit, dërguar Muhamedit a.s. nëpërmjet engjëllit Xhibril. Ky revelacion ka direktiva e udhëzime që kanë karakter universal dhe zbatohen në çdo kohë. Ai është pra përmbledhje e revelacioneve të hershme. Është e vetmja kopje e plotë dhe autentike e fjalës së Zotit. Kopja e tij që përdorim sot, është e njëjta fjalë për fjalë, siç iu revelua profetit Muhamed a.s. nga Allahu 14 shekuj më parë, e pra nuk ka as shtesa, as ndryshime, as lënie jashtë, as tjetërsime në të.

Sa i rëndësishëm është Kur'ani i shenjtë për myslimanët?

Përderisa çdo fjalë e tij është nga Zoti, secila ka forcën dhe efektin e vet hyjnor. Prandaj Kur'ani ka një status të veçantë për myslimanët dhe është një epiqendër e Islamit. Ai na kujton qëllimin e vërtetë të detyrave që kemi, të shpërblimeve e të dënimeve që kemi, prandaj quhet edhe "mëshirë", "bekim", "lajmëtar", "paralajmërues". Myslimanët përdorin gjithën kohën e tyre duke e studiuar atë, duke e mësuar përmendësh, duke menduar për të, duke e zbatuar e vënë në jetë. Ata e lexojnë dhe e recitojnë atë, sepse është dëshira e tyre për të qenë afër Zotit nëpërmjet fjalës së Tij. Ata kërkojnë të fitojnë kënaqësinë e Tij duke zbatuar urdhrat që jep nëpërmjet Kur'anit. Nuk ka libër tjetër që të jetë mësuar krejt përmendësh si Kur'ani. Miliona myslimanë e dinë atë përmendësh.

Çfarë madhësie ka Kur'ani? Kur'ani, në gjuhën arabe, nuk është një libër shumë voluminoz. Ai është përkthyer në shumë gjuhë të botës, edhe në shqip. Kur'ani ka 114 sure (kapituj) nga të cilat më e shkurtra ka 3 versete (ajete) dhe më e gjata 286 ajete. Në këto 114 sure përmbahet urtësia supreme hyjnore, urtësi që shërben për të gjithë ata që kërkojnë të vërtetën, sepse vetë Kur'ani është universal. Ai është për ta lexuar çdo njeri; njerëz të zakonshëm, dijetarë, specialistë të degëve të ndryshme shkencore, njerëz të thjeshtë, të rinj, të moshuar, myslimanë e jomyslimanë. Ai i drejtohet të gjithë njerëzimit me këto fjalë: "O njerëz...". Kur'ani i kënaq të gjithë njerëzit me simfoninë e fjalëve të tij, me tregimet e tij, me bisedat me karakter intelektual në përgjithësi. Kur'ani të

tërheq me pasurinë e tij të pashtershme në çdo fushë, me kuptimet e tij të thella e me mendimet e tij.

Përse Kur'ani quhet një mrekulli e gjallë dhe e përjetshme? Bukuria e Kur'anit qëndron në stilin e tij lakonik. Fjalët e frazat në arabisht shprehin kuptimet më të pasura e më të forta në formën më të shkurtër. Fjalë për fjalë dhe frazë për frazë Kur'ani i lexuar, thur së bashku, si një palë vargje, anën magjike në mendjen e njeriut. Leximi i tij ka një forcë të mrekullueshme dhe bukuri fonike; është brendia tërheqëse për mendjen, tingulli më i këndshëm për veshin. Një dijetar mysliman thotë: "Stili i Kur'anit është i fortë, emfatik si dhe i butë e delikat, sipas përmbajtjes. Lexuesi mund ta ndiejë atë të kumbojë si shkëmbinjtë, si dhe butësinë e finesën e tij të pafund. Nëse leximi i Kur'anit mëmërit si një burim i qetë ose kumbon si një përrua, bukuria e tij është e pakrahasueshme. Ai buzëqesh dhe metaforat godasin imagjinatën me një forcë të madhe, që e lë tjetrin pa frymë dhe të bën për vete".

Për arsye se ai është i vetëm dhe nuk mund të krahasohet ose të barazohet në bukuri e përsosmëri, Kur'ani nuk mund të hartohet nga mendja njerëzore, qoftë edhe nga një tubim i mendjeve më të shkëlqyera të botës në tërësi. Ai ka bukuri, madhështi, hir e një stil të vetëm që nuk gjendet gjë paralel me të.

Ç'ëndë e ç'subjekte trajton? Madhështia e larmia e tematikës së Kur'anit është unike. Asgjë nuk është lënë jashtë tij. Ai ka katër ndarje kryesore të subjekteve:

- Pjesët që urdhërojnë adhurimin e Zotit dhe të kujtuarit e krijimeve të bëra prej Tij. Këtu hyjnë parashikimet e të gjitha zbulimeve shkencore në fusha të ndryshme, si astronomi, fizikë, kimi, biologji, etj.

- Eskatologjia: Ringjallja, Dita e Gjykimit, shpërblimi e dënimi në jetën pas vdekjes.

- Histori e tregime rreth profetëve të hershëm. Kur'ani, si për të gjithë profetët, flet me nderim për Isain e nënën e tij, Merjemin, për të cilën një kapitull i tërë është emërtuar me emrin e saj, si një grua e dalluar mes të tjerave.

- Përmbajtje urdhrash e normash për mënyrën e trajtimit të punëve e çështjeve tokësore.

Kështu, Kur'ani përmban kodin e përgjithshëm të botës islame, atë shoqërore, tregtare, civile, ushtarake, gjyqësore, penale e fetare.

Zoti na tregon në Kur'an rreth natyrës

njerëzore dhe se qëndrimi ideal i mendjes njerëzore është praktika dhe arsytimi. Kur'ani na mëson çlirimin nga kontradikta dhe paradoksi, i fton njerëzit të pranojnë mesazhin e tij me racionalitet, kritikë e pa dhunë. Ai thekson përdorimin e gjykimit personal. Kur'ani na jep kriterin për të dalluar të mirën e të keqen, na udhëheq të kërkojmë një bilanc në jetë. Nga ana shpirtërore ai na pastron shpirtin nga dëshirat e këqija dhe na përgatit për të hyrë në xhenet.

Ç'është impulsi i Kur'anit? Për ata që e dëgjuan Kur'anin të lexohej nga Profeti Muhamed a.s., ai ishte një realitet i gjallë dhe një forcë që ia mposhte krejt jetën. Ai ushtroi një forcë goditëse, tërheqëse. Ushtroi një pushtim shpirttrash, zemrash, mendjesh dhe vullnetin e tyre. Vetë recitimi i përpiu ata, duke e njohur origjinën e tij hyjnore dhe i nënshtroi me kushtet që iu shtroi revelacioni hyjnor. Kur'ani solli transformime në individë e në mbarë shoqërinë, në zemrat e besimtarëve. Ai krijoi një fazë të re mendimesh njerëzore dhe një tip të freskët të karakterit. "Ata që ndoqën këshillat e Librit të madh u bënë formësuesit e një qytetërimi që la gjurmët e veta të mrekullueshme deri më sot, duke i bërë drejtues të njerëzimit".

Kur'ani e ftoi njerëzimin në vepra të ndryshme dhe në shkencë, sepse vetëm me anë të kuptimit të krijimit të Zotit mund ta forcojmë besimin tonë në pushtetin e Tij suprem. Kështu, myslimanët mund të jenë njëherazi besimtarë dhe shkencëtarë, në mes të të cilëve nuk ekziston asnjë konflikt apo mosmarrëveshje.

Konkluzioni: Kur'ani është me të vërtetë një fenomen unik në historinë e kulturës njerëzore, e pra nuk është një libër sido kudo. Duke qenë fjala e Zotit, ai nuk mund të zëvendësohet me prodhime e vepra njerëzore. Ai është një thesar i çmueshëm dhe si i tillë respektohet nga të gjithë myslimanët. Është një libër për të gjithë kohërat, vendet, racat, një libër për të gjitha arsytimet. Duke lexuar atë, njeriut i përftohet një zgjerim njohurish, ndërsa shpirtit të tij i sigurohet një shpërblim, kështu që, me plot gojën, mund të themi: "O Zot, Fjala Jote është e vërtetë."

Ismail H. Muçej



مصحف قطر

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

رواية حفص عن عاصم

Njohja e Zotit



“Ne do t’ua tregojmë shenjat Tona në horizonte dhe në vetet e tyre gjersa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është e vërteta. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fusilet, 53)

Zoti i shfaqet njeriut në tre mënyra: 1. Në gjithësi, 2. Në veten e tij, dhe 3. Përmes Shpalljes.¹ Kujtojmë se, në kohën para shpalljes, Pejgamberi a.s. vetmohej në shpellën Hira duke medituar dhe duke qëndruar me net të tëra në zhytje të thellë metafizike saqë nganjëherë harronte edhe të hante sepse ngopej me ushqimin shpirtëror.² Profeti a.s. më së miri e ilustron shembullin e gjetjes së Zotit ku gërshetohen të tria mënyrat në të cilat u shfaqet Ai kërkuesve.

Pejgamberi meditonte e mbyllej në vetvete duke shikuar Qaben e mbushur me idhuj që konsideroheshin si perëndi nga të tjerët, kurse ai kërkonte diçka tjetër, e cila i tejkalonte fuqitë materiale dhe të cilën nuk e kapin mendjet e njerëzve, pikërisht sikurse paraardhësi i tij Ibrahim a.s., i cili e kërkoi Zotin³ në mesin e të krijuarave, të cilat i kap mendja i sheh syri, por ai nuk e gjeti, pasi Absoluti është jashtë konceptimit të shqisave tona. Por është Ai i cili gjendet më afër se damari i qafës⁴ tonë ose më afër se vetja jonë,⁵ Ai të cilin Profeti a.s. e kërkonte me meditim dhe abstenim nga e krijuara fizike duke u ngritur drejt së pakrijuarës.

Mënyra e dytë e shfaqjes së Zotit ndaj robërve të Tij është Shpallja, e cila përbën gjuhën e botës së padukshme në botën e dukshme dhe i kujton njeriut zanafillën e tij para-ekzistenciale.⁶ Njëkohësisht, fjala (kelam) e Zotit dhe i Dërguari i Tij plotësojnë dy anët e shpalljes, anën tejhistorike (vahj) dhe atë që e bën shpalljen historike, pra zbërthimi i profetëve, të cilët në çdo kohë shpjeguan shpalljen dhe e bënë të kapshme për njerëz. Muhamedit a.s., i cili e kishte pastruar anën e tij të brendshme (me anë të meditimit) dhe e kishte gjetur natyrshmërinë e vet, e cila si pikënisje për çdo udhëtar (i cili nisët në rrugë për ta gjetur Zotin), i paraqitet Fuqiploti në dimensionin e komunikimit (shpalljes) dhe e cila ishte puqja e kahershme për shkak të së cilës u krijua bota.⁷ Vjen zëri i Xhibrilit a.s., i cili konfirmon vërtetueshmërinë e Fjalës së Zotit,

1. Të shihet William C. Chittick, Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit: përshtatsia e kozmologjisë islame në botën moderne, shqipërimi, parathënia dhe shënime Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2009)

2. Reshit Hajllamaz, Profeti Ynë (Tiranë: Prizmi 2013), f. 66-67

3. Surja el-En`am: 76-77

4. Të shihet ajeti 16 i Sures Kaf

5. Të shihet, William C. Chittick, Doktrina sufiste e Rumiut, shqipërimi dhe parathënia Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2009)

6. Said Nursi, Shenjat e Mrekullisë (Stamboll, p.d.), f. 24

7. Aludim për hadithin e njohur kudsî “Po të mos ishte ti, nuk do ta krijoja botën”

kurse për Pejgamberin a.s. ishte gërshetim i asaj që e përjetonte në zemër dhe asaj që po e dëgjonte me veshë, shqisa këto të cilat së bashku me sytë, Kur’ani i cilëson si rrugë për të arritur deri te e vërteta, kur thotë:

“Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja kur nuk dinit asgjë. Ju pajisi me të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, që të jeni falënderues.”⁸

Aspekti i tretë i paraqitjes së Zotit është kozmosi. Ai është i lidhur me shpalljen dhe me shpirtin e njeriut esencialisht sikur një objekt i vetëm, por i ndarë në pjesë,⁹ të cilat mbështesin njëra-tjetrën dhe dëshmojnë të vërtetën e vetme për të cilën janë krijuar.

Ibrahimi a.s. e gjeti Zotin e tij duke soditur kozmosin ose duke lexuar atë që dëshmonte kozmosi.¹⁰ Përveçse janë të vendosura në libër, ajetet (shenjat) e Allahut janë edhe në kozmos dhe leximi i tyre përmban kuptim dy dimensional. Pra, leximin e librit me shkronja e fjalë dhe leximin e kozmosit dhe të shenjave të tij. Muhamedi a.s., analfabet në leximin e shkronjave dhe fjalëve, por shëmbëlltyrë e njerëzimit në leximin e shenjave të larta të Zotit të vendosura në kozmos dhe në gjetjen e zanafillës dhe rrugës për lumturinë e përfundme.

Ai i cili ishte “i parinë planifikim dhe i fundit në realizim”,¹¹ po bëhej dëshmitar i mishërimit të mikrokozmosit në makrokozmos dhe dëshmitar i pranisë së pandërprerë hyjnore brenda krijimit. Prani e domosdoshme dhe e vetmja reale kjo, prej të cilës njeriu merr një realitet të kufizuar të ekzistencës.

Rruga e Muhamedit a.s. është shembulli më i mirë i arritjes së shkallës më të lartë të përsosjes njerëzore (Insanu’l Kamil) dhe arritjes së harmonisë tokësore me hyjnoren, e cila njëherësh përbën edhe qëllimin e ardhjes së njeriut në këtë botë.

Ramazan Fetahu

8. Surja Nahl ajeti 53

9. Chittick, Shkencë e Kozmosit, shkencë e shpirtit

10. Sureja el-En`am, 78-79

11. Rregulli i cili aludon në hadithin e njohur Kudsî “Po të mos ishte ti nuk do ta krijoja botën”

Profeti ynë cakton mësues, që të shkonin nëpër qyteza të ndryshme dhe t'u mësonin njerëzve *Islamin*



Në Medine dërgon Musab bin Umejrin

Uruetu bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon: "Kur ensarët u bindën, me mendje dhe me zemër, për të gjitha të vërtetat ku i kishte ftuar i Dërguari i Allahut, pasi i kishin dëgjuar me vëmendje të gjitha fjalët e tij, besuan dhe i shprehën besën e plotë që mund të kishte tek ata. (Siç u trajtua edhe më parë, ata gjashtë njerëz që u takuan me të Dërguarin e Allahut në Akabenë e Parë, e që u kthyen për në Medinë me premtimin se do të ktheheshin sérish vitin e ardhshëm, për të kryer detyrimin e Haxhit; ky kthim në Medinë u shndërrua në një të mirë shumë të madhe për ata njerëz.) Po, ata gjashtë njerëz i patën dërguar lajm të Dërguarit të Allahut, ku i thoshin:

- "Na dërgo një njeri nga ata që ke pranë vetes, që t'i ftojë njerëzit, t'i binden Librit të Allahut. Kjo ka për të ndihmuar që njerëzit të njihen më shpejt me Librin." Ata që e prunë këtë lajm, sipas transmetimit, ishin Muadh bin Afra dhe Rafi bin Maliku.

Pas kësaj kërkese i Dërguari i Allahut dërgoi atje Musab bin Umejrin, që ishte vëlla me bijtë e Abdudarit. Në Medinë Musabi qëndroi në shtëpinë e Es'ad bin Zurares (radijallahu anhu), i cili i përkiste fisit të Beni Ganemit. Bisedonte me ta dhe u lexonte vazhdimisht pjesë të Kur'anit. Bijtë e Nexharit nisën të ushtronin trysni mbi Es'ad bin Zuraren, e, kështu, ata u detyruan që ta largonin Musabin nga shtëpia e tyre. Atëherë Musabi u zhvendos në shtëpinë e Sad bin Muadhut. Ai e ndihmoi shumë shpirtërisht, duke i thirrur njerëzit vazhdimisht për te feja e vërtetë e Allahut. Nëpërmjet tij Allahu po i udhëzonte një e nga një të gjithë ensarët, aq sa në tërë shtëpitë e ensarëve vetëm shumë pak shtëpi kishin mbetur pa pranuar fenë islame. Me Islamit që nderuar edhe Amr bin Xhemuhu dhe i gjithë besimi që ai kishte pasur tek idhujt i ishte zhbërë. Musab bin Umejri (radijallahu anhu) u kthye pranë të Dërguarit të Allahut dhe paskëtaj Musabi nisi të thirrej me emrin "Mukri", që do të thotë "Mësues i Kur'anit"

Profeti ynë cakton mësues për vendasit, Ebu Umamen

Ebu Umameja (radijallahu anhu) tregon: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi mua, që t'i ftoja njerëzit në fenë e Islamit dhe t'u shpallja atyre shtyllat dhe kushtet e besimit. Kur shkova pranë tyre, ata kishin çuar devetë për të pirë ujë dhe qumështin ua kishin pirë. Kur më panë, thanë:

- "Përhëndetje, Sudaj bin Axhlan! Kemi dëgjuar se edhe ti e ke braktisur fenë dhe ke kaluar në anën e atij njeriu."

- "Jo, unë kam besuar tek Allahu dhe tek i

Dërguari i Tij. Resulullahu më ka dërguar që t'ju flas për Islamit dhe urdhëresat e tij", – u përgjigja unë.

Pastaj, ata shtruan pjata plot me gjak dhe filluan të mblidheshin rreth njëri-tjetrit, për të ngrënë. Më thanë edhe mua:

- "Eja të hash, Sudaj!"

- "Turp t'ju vijë! Unë vij tek ju prej Profetit që e ka shpallur të ndaluar këtë që po hani, sepse e lejuar (hallall), për t'u ngrënë, nuk mund të jetë veçse ajo që është prerë, duke u përmendur emri i Allahut."

- "E ç'na paskësh thënë kështu ai njeri?", – pyetën ata.

- Atij i është zbritur një ajet lidhur me këtë çështje: "Është e ndaluar për ju ngrënia e cofëtinit, e gjakut, e mishit të derit, e mishit të kafshës që është therur jo në emër të Allahut, e mishit të kafshës së mbytur në fyt, e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur, e mishit të kafshës që është vrarë nga rrëzimi, apo nga brirët e kafshëve të tjera, e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat e tjera – përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin. Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve, apo për të kërkuar fatin në fall. Të gjitha këto që u përmendën, janë gjynah. Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje! Sot, jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj. Por kushdo që është i shtrënguar nga uria (dhe ha çfarë është e ndaluar), pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Maide, 5/3)

Unë nisa t'i ftoja ata të pranonin Islamit, mirëpo, se ç'kish diçka që i bënte të ngurronin.

- "Turp t'ju vijë! Më jepni të paktën një gllënjë ujë, të pi, se po digjem nga etja!" – u thashë.

- "Nuk kemi për të të dhënë ujë, por do të lëmë të vdesësh, kështu, nga etja!"

Me vete kisha edhe çallmën, të cilën e lidha rreth kokës dhe dola, por më kishte zënë gjumi dhe kur u zgjova e gjeta veten të shtrirë mbi rërën përvëluese. Në gjumë erdhi dikush e më dha diçka për të pirë. Ishte një pije, shijen e së cilës nuk e kisha provuar asnjëherë më parë. Ai ma dha atë pije dhe unë e piva; kur e mbarova më doli gjumi. Vërtet, pasi piva atë pije, mua nuk më zuri më asnjëherë etja."

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH**

Shpirti

**je gjëja më e
bukur e kësaj bote**

Nuk ka gjë më të bukur në këtë botë sesa ju o njerëz. Nuk ka gjë më të bukur mbi planetin tokë sesa ju o njerëz. Në Kur'an, Zoti i lartësuar thotë për ju: "Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit, i kemi mbartur në tokë e në det dhe i kemi furnizuar me të mira, i kemi favorizuar ndaj shumë krijesave të tjera."

Ti o njeri je thesari më i shtrenjtë në këtë jetë, je më i shtrenjtë sesa xhevahiret, floriri e argjendi, se çdo krijesë tjetër. Ti je xhevahiri i këtij universi, prandaj mos ia humb vlerat vetes duke dalë kundër Zotit, duke kundërshtuar të dërguarit e Tij dhe duke refuzuar ligjet e Tij.

Ti o njeri je privilegjuar me fjalën hyjnore, ku manifestohet përkujdesja e Zotit. Gjithçka në tokë të është nënshtruar për të shërbyer ty, detet, lumenjtë, pemët, frutat, malet... të gjitha janë krijuar për të të lumturuar dhe kënaqur ty. Festivali i kësaj jete është organizuar për ty.

O njerëz, ne të gjithë jemi vëllezër, pasi ajo që na bashkon është humanizmi, ne jemi banorë të këtij planeti dhe ne të gjithë jemi stolia më e madhe e tij. Poeti Ilja Ebu Madi thoshte:

Njerëz të dashur, e bukur është kjo botë me ju
Shëmtia s'ka vend, përderisa ju shoh mbi tokë, këtu.

E çfarë vlere do të kishte toka pa njerëz? Çfarë vlere ka pranvera, nëse nuk rrethohesh nga njerëz? Prandaj dhe njerëzit thoshin më parë: "Një tokë pa njerëz, nuk shkelet me këmbë."

Edhe pse në parajsë, Ademi a.s. u mërzi krejt i vetëm, prandaj dhe Zoti i krijoi gruan, Havanë, me qëllim që tek ajo të gjejë prehje. Ajo u bë prehja e Ademit a.s.

Pallatet pa njerëz janë varre, lulishtet pa njerëz janë shkretëtira, udhëtimi pa njeri është tmerr, jeta pa popuj është një greminë. Prandaj dhe Zoti na e ka bërë obligim që të njihemi me njëri-tjetrin, të bashkëpunojmë, të komunikojmë dhe të ngremë ura dialogu. "O njerëz, Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër, ju kemi bërë popuj dhe fise që të njiheni. Më i fismi te Zoti, është më i devotshmi."

Lidhur me interpretimin e "që të njiheni", thuhet: Që ta njihni njëri-tjetrin, të pranoni të drejtat karshi njëri-tjetrit dhe të mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit. Gjithashtu, thuhet se ka të bëjë me të bërit mirë ndaj njëri-tjetrit, ta ndihmoni, ta vizitoni dhe ta motivoni njëri-tjetrin.

Vëllezër njerëz. Le të bashkohemi nën hijen e një bese të përbashkët, të mos adhurojmë zot tjetër përveç Krijuesit, duke mos i shoqëruar rival, të mos i bëjmë padrejtësi njëri-tjetrit, të mos pushtojmë njëri-tjetrin, të mos përjashtojmë njëri-tjetrin, të mos vrasim njëri-tjetrin... Le të bashkëpunojmë për ndërtimin e një jete të bukur mbi tokë, për ndërtimin e një civilizimi me bazë drejtësinë, një qytetërimi vlerash, ku mungon padrejtësia, tradhtia, mashtrimi, plaçkitja dhe banditizmi.

Hidhini armët nga duart dhe në vend të tyre mbani degët e ullirit, zëvendësoni bombat me bereqet, gjembat me trëndafila, hanxharët me lapsa, pushkët me libra. Le

të jetojmë në paqe dhe siguri me veten, familjet, fqinjët dhe popujt tanë.

Po të kisha diçka në dorë, çmimin që iu dha inxhinierit rus që shpiku kallashnikovin, që ka vlarë miliona njerëz mbarë bote, do ia hiqja dhe do ia jepja Tomas Edisonit, shpikësit të llambës, e cila ndriçon gjithë botën.

Neve na lipset paqe, ushqim, dashuri, respekt, miqësi dhe harmoni, më shumë sesa luftërat, vrasjet, konfliktet dhe polemikat.

"O ju që keni besuar, bëhuni totalisht pjesë e paqes."

Le të hyjmë nën çadrën e paqes të gjithë. Islami erdhi për paqen, përshëndetja e tij është paqe, mesazhi i tij është paqe, takimet tona fillojmë me paqe. Prandaj, paqja e Zotit, mëshira dhe begatitë e Tij qofshin me të gjithë ju.

John C. Maxuell, në librin e tij të mrekullueshëm "Fitorja me njerëzit" bën thirrje për të mos hapur luftëra me njerëz, individë qofshin apo grupe, sepse në fund të fundit, do të jesh i humbur. Metoda e Kur'anit është depërtimi në zemrat e tjetrit me mirësi. Zoti në Kur'an thotë: "Ktheje me atë që është më e mirë dhe do të shohësh se armiku do të shndërrohet në mik të ngushtë."

Në dhomën time, mu mbi vendin ku fle, kam të shkruar: "...dhe ata që vetëpërbahen dhe i falin njerëzit."

Sa herë që lexoj ndonjë kritikë që më bëhet, ndonjë sharje dhe ofendim, më kujtohet ky pasazh i Kur'anit dhe them me vete: "Zoti ju faltë!"

Na duhet që të mirën që kemi brenda në zemra, ta kultivojmë dhe shtojmë. Nëse tjetri të afrohet një hap, afroju dhjetë hapa, nëse të zgjat dorën dhe ta shtrëngon atë, ti hidhu në qafë dhe përqafoje, nëse të përshëndet, ktheja me një përshëndetje më të mirë. Dil nga bahçja e urrejtjes, mllëfit dhe smirës, për në bahçen e dashurisë, paqes, vëllazërisë dhe dëlirësisë. Shkuli gjembat dhe ferrat nga lulishtja e zemrës tënde dhe në vend të tyre mbill lule e trëndafila. Sa herë që të ofendojë ndonjë mendjelehtë, i thuaj "Paqe" dhe vazhdo rrugën. Paqja është parajsja e Zotit mbi tokë, është ajo ëndërr e bukur njerëzore, është besa e nderit mes individëve të shoqërisë njerëzore. Mu për këtë janë caktuar edhe çmime ndërkombëtare të mëdha për këdo që kontribuon në vendosjen e paqes dhe sigurisë në botë.

Eric Hoffer, në librin e tij "Besimtari i singertë" thotë: "Ekzistenca individuale, edhe kur ka një kuptim, është e kotë, e pavlerë dhe e pakuptimtë. Ajo i ngjan më shumë mëkatit". Më pas, ai bën thirrje për shpirt kolektiv, tolerancë dhe ndershmëri në komunikimin me njerëzit.

Sa prekës është qëndrimi i profetit Muhamed a.s. me kreun e munafikëve, Abdullah bin Ubej bin Selul, i cili kishte komplotuar kaq shumë për ta shuar dritën hyjnore dhe të dërguarin e Zotit a.s., "Nuk dua të flasin njerëzit dhe të thonë se Muhamedi vret shokët e tij", u tha atyre që e kundërshtuan aktin e tij fisnik.

Përktheu: Elmaz Fida

REAQJIM!





Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është institucioni më i lartë dhe i vetëm i përfaqësimit zyrtar të myslimanëve në Republikën e Shqipërisë.

Si i tillë ky komunitet është një institucion i pavarur dhe vetëqeverisës, i cili ka një statut të regjistruar dhe të njohur nga organet përkatesë të Republikës.

Bazuar në statutin e tij, Komuniteti Mysliman është në periudhë zgjedhjesh të përgjithshme në të gjitha nivelet e organizimit të tij, nga qeliza më e vogël (xhamia) në rang myftinie e deri në plotësimin e Këshillit të Përgjithshëm, që është organi më i lartë i institucionit tonë.

Në të gjitha hallkat ky proces është ndër më demokratikët në vend dhe funksionon si i tillë në çdo proces elektorale dhe vendimmarrje më pas.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë gjen rastin të falenderojë të gjithë myftinjtë, imamët dhe anëtarët e këshillit të xhamive dhe myftinive në Republikën e Shqipërisë për angazhimin

në njësitë e tyre qeverisëse për menaxhimin, mbarëvajtjen dhe garantimin e një procesi zgjedhor të lirë, demokratik dhe të barabartë për të gjithë, konform statutit.

Ne jemi krenarë dhe mbështetës të pakushtëzuar të myftinjve tanë, imamëve, e çdo personi që ka zgjedhur me dëshirë të japë kontributin e tij në përcimin e vlerave madhështore të islamit në Shqipëri.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është i vendosur t'u qëndrojë fort parimeve të drejta e të pastërta të islamit dhe të ndjekë traditën e paraardhësve tanë.

Komuniteti Mysliman është gjithashtu i vendosur të mbështesë e t'i qëndrojë fort vlerave demokratike dhe euroatlantike të vendit tonë, ashtu siç ka qenë në një shekull ekzistencë të tij.

Asnjë shpifje apo sajese nuk do të mund ta çënojë aktivitetin dhe misionin e këtij institucioni për t'i shërbyer fesë së Zotit dhe kombit.

Mosmirënjohësit



Njeriu është qenie, e cila nuk mund ta jetësojë modus vivendi-in, pa u implikuar me tjetrin. Tjetri nuk mund të jetë vetëm i afërmi, miku, shoku, por gjithçka që implikohet dhe ndikon në jetën e tij, gjithçka që implikohet dhe ndikon në idetë, mendimet, perceptimet e njeriut. Vetmia është e papranueshme për njeriun, kështu ai do të njohë drejtpërdrejtë apo tërthorazi gjithësa do të implikohen në jetën e tij. Ne nuk mund të jemi të sigurt për thellësinë dhe vërtetësinë e njohjes së tjetrit, që qëndron jashtë nesh, sepse njeriu është dhe mbetet ende një qenie që mbetet për t'u zbuluar. E përtej kësaj pamundësie, ne nuk mund t'i shmangim apo evitojmë raportet reciproke me sillojin tonë.

Njerëzit kanë natyra të ndryshme dhe rrjedhimisht po aq sa natyra ka, po aq modele të sjelluri do të gjesh, po aq modele gjykimesh e perceptimesh do të ndeshësh. Nuk mund të përcaktojmë me siguri masën, sasinë e atyre që do të implikohen në jetën tonë, por as nuk mund të përcaktojmë dhe mënyrën se si do të ndikohet jeta jonë nga masa e të implikuarve. Të bësh të tilla përllogaritje, për të nxjerrë me saktësi matematikore si e qysh do të ndikojnë të tjerët në jetën tonë, do të thotë që të lodhemi pa vjelë fryte. Prandaj në skenë shfaqet fati, sepse ne mund të duam ta evitojmë tjetrin si një të keqe, po fati thotë jo; sepse ne mund të duam ta bëjmë tjetrin si pjesë e jona duke e menduar si të mirë, po fati thotë jo. Kjo nuk do të thotë që ne të mos lodhemi për të kuptuar natyrat e të tjerëve, por zakonisht reflektimi ndodh pasi e ke pësuar. Është në natyrën e njeriut që në momentin kur dëshiron që dikush të bëhet pjesë e të implikuarës në jetën e tij, të mos vërejë apo të anashkalojë pjesën e keqe të cilësive, sepse askush nuk është i imunizuar absolutisht prej së keqes. Gjithsesi, implikimi do të ndodhë medoemos, e miratuar apo nuk e miratuar ne.

Qenia njerëzore, që të ketë dhe për më tepër ta meritojë këtë status të lartë, duhet të udhëhiqet në jetën e vet nga principe morale, të cilat shërbejnë për pajisjen e tij me virtyte. Pa principet morale dhe pa virtyte nuk mund të ketë jetë të njëmendtë, pavarësisht se çfarë pretendojnë njerëzit. Por, që këto principe të japin frytet e duhura, duhet të ndodhë ngjarja më tronditëse për jetën e njeriut, zgjimi nga gjumi i harresës. Për të ndodhur kjo ngjarje duhet çarë dhe hapur zemra, porsia një lirishtë, për të pranuar kandilin që shpërndan mjegullnajën e pluhurit të harresës dhe e kthen zemrën në fidanishten e virtyteve që duhet t'i japin formë jetës së qenies njerëzore. Që të ndodhë kjo, pranimit duhet të jetë i sinqertë dhe i pa molepsur me asnjë lloj bashkëngjitje tjetër që mund ta shprishë këtë pranim, kur të vijë koha e të provuarit për sinqeritetin e pranimit.

Për të qenë të sinqertë dhe për hir të së vërtetës, duhet ta pranojmë që jo të gjithë ata që kanë

pretenduar dhe pretendojnë se janë në rrugën e të qenët njerëz me principe dhe virtyte, nuk qëndrojnë në të njëjtin nivel me pretendimin që kanë edhe pse këtë e shprehin me rrahje gjoksi, sikur ajo çfarë kanë pranuar të jetë meritë e tyre. Prandaj do të gjesh pretendime pa pretendentë, të sinqertë pa sinqeritet, të mirë pa mirësi, të drejtë pa drejtësi, të dashur pa dashuri, të virtytshëm pa virtyte, të principshëm pa principe, të moralshëm pa moral.

Kështu, nga masa e atyre që implikohen në modus vivendi-n tonë, një pjesë ndoshta dhe e konsiderueshme do të jenë e këtij kallëpi, por ne nuk jemi gjykatësit e asaj çfarë mbështjellin në brendësinë e tyre. Megjithatë, koha e provës nuk do të kursejë askënd dhe herët a vonë ajo që ishte mbështjellë me kujdes, do të fillojë të hapet dhe të bëhet e dukshme se çfarë në të vërtetë ishte mbështjellë me aureolën e principeve morale. Duhet ta pranojmë realitetin ashtu siç është dhe të mos biem në grackën e zhgënjimit apo pesimizmit, pavarësisht se në rrugën tonë jemi ndeshur apo mund ta kemi pësuar nga qeniet e këtij kallëpi. Zhgënjime dhe pësime ka çdokund dhe mund t'i presësh nga çdokush, por në qoftë se je në rrugën e të sinqertëve, padyshim që bashkë me ato që ke përjetuar, ke mësuar dhe ke nxjerrë mësim të vlefshme, të cilat ndoshta nuk do t'i kishe mësuar në ndonjë gjendje apo situatë tjetër jetësore.

Tek e mbramja, gjithsecili mban përgjegjësi fillimisht për veten e vet, për mënyrën se si i jetëson principet morale dhe nuk mund të fajësojë veten pse ata që janë në sferën e implikimit shfaqin të tilla deformime. Secili është i angazhuar me atë që përbën sferën e tij të interesit, por gjithsesi duhet të ndjejmë keqardhje për këtë kategori njerëzish, dhe jo vetëm, që edhe pse kanë prekur një terren tepër të lakmueshëm, nuk e çmojnë vlerën e të çmuarës me të cilën kanë rënë në kontakt. Dhe këta janë mosmirënjohësit më të mëdhenj, sepse nuk çmojnë me rëndësinë që duhet të çmuarën. Janë mosmirënjohësit më të mëdhenj, sepse tregohen të lehtë përballë asaj që kërkon seriozitet. Janë mosmirënjohësit më të mëdhenj, sepse përballë principeve nuk e mposhtën egon dhe narcizmin e tyre, për të bërë përmbysjen e madhe brenda vetes. Dhe kur janë mosmirënjohës ndaj kësaj dhurate të paçmuar që iu është dhënë, si do të jenë mirënjohës me sillojin e tyre? Përtej të mirave që u bëhen, gjithmonë do të jenë duke rendur pas ndonjë qejfmbetje apo hatërmbetje, e cila nuk është asgjë me të mirat që iu janë bërë. Por këtu nuk ka vend për pesimizëm, sepse secili jeton jetën që meriton.

Ne na takon që të jemi në antitezë me mosmirënjohësit dhe të punojmë që të jetojmë dinjitetshëm nën hijen e principeve morale dhe virtyteve që vijnë prej tyre, pasi që nuk jetojmë vetëm për këtu dhe tani.

Këshillat e filozofëve

Thuhet se motit mbretërit për çashtje të vështira kërkojshin gjithmonë këshillat e dijetarëve dhe punofshin për mbas atyne porosive. Ndër këto kohna njerëzit shkojshin sa ditë udhë larg për me u këshillue me njerëzit e urtë. Nushirevani Adili, mbret i përmendun i Persisë, tue dëshirue me pasë të mbledhun në një vend disa këshilla të urta që do t'i vyeshin si rregulla për të gjitha çështjet gjatë jetë së tij, pat thirrë të gjithë dijetarët që u gjindshin në mbretnin e vet dhe prej këtyre pat zgjedh njëzetetë vetë, të cilëve iu pat vue për detyrë për me shkruë secili ka një këshillë urtije. Dijetarë si mbas porosisë së mbretit e kryen detyrën e tyre dhe kështu qenë plotësue njëzetetë këshilla që po i rreshtojmë këtu poshtë të cilat përmbajnë bazat themelore fetare e këshillore. Nushirevani mandej i pat shkruë me shkronja arit këto këshilla dhe i pat ruejtë në thesarin e vet në një arkë florini. Ky mbret për çdo punë e çashtje me randsi ma parë këndonte këshillat e filozofëve e mandej vepronte. Këshillat janë këto:

I

Njife vet-vehten. Kërko dijen sado larg që të

jetë. Mos të kesh turp për me u mësue edhe mos e kalo jetën në padituni. Dije se ditunija asht ma e madhe dhe ma e kushtueshme nga çdo gja. Dije se asht i madh ai njeri që di me çmue ditunin. Mos e thuej atë që tjetri nuk e thotë edhe mos kërko atë çka askush nuk e kërkon.

II

Çmoji këshillat e dijetarëve. Ndero fjalët e të moçmëve e këshillohu dhe bisedo me të urtit. Kërko këshillë për çdo punë prej atij që asht kompetent në atë punë. Bane çdo punë në kohën e vet. Në asnjë punë mos u ngut me tepri. Para se ta fillosh një punë, mendoje mirë fillimin dhe mbarimin e saj. Të kesh kujdes të ruhesh prej sendeve që mundën me të shkaktue ndonjë dam e fatkeqësi. Mos e provo atë që asht provue.

III

Të jesh i sjellshëm dhe i dashtun e mos të jesh i ashpër dhe kryenaltë. Të jesh i devotshëm dhe ta kesh frikë Zotin dhe me këta të përmendesh. Përgatitu për jetën tjetër. Mos e shit jetën tjetër për këtë. Dije se kursimi asht pasunija. Fito emnin e mirë. Mos të dhimbset çka asht thye e derdhë. Mos u gëzo për të keqen e tjetrit.

IV

Merrni mësim nga pësimi i tjetrit. Ma mirë dami që vjen me kohë se fitimi që vjen pa kohë. Të jesh i dashtun dhe i sjellshëm ndaj gjithkujt e mos u ban i ngushtë e i ngutshëm. Të jesh mik me mikun dhe me armikun. Mos i zgjat këmbët përtej maset (mos i zgjat këmbët përtej jorganit).

V

Punët tuaja mati me masën tande. Mos prek aty ku nuk ke vue (mos prek gjënë e huej). Të jesh fisnik. Ruaj duart e gjuhën dhe mos i përlyej. Ruaju prej punovet të dobëta dhe të pameritueshme. Largoju mikut të keq.

VI

Mos i ndihmo të pandershmit. Largoju fqinjët të keq. Mos ban rrugë pa shoq. Mos udhëto me shokun e keq. Mos mbill pemë në tokën e huaj.

VII

Mos hidh farë në tokën që nuk mbin. Mos i hyn borxh atij që e ka fitue rishtas. Mos u marto me bijat e burrave të padenjë e të demoralizuem. Mos u bashko me ata që nuk dinë me e çmue veten. Mos u bashko me shërbëtorët e huej. Druje atë që nuk dron Zotin.

VIII

Mos të dhimbset gjaja e harxhueme me vend. Mos nderon të dejshmin e të marrin. Ndero vetëm ata që çmojnë e njohin këshillin tand. Mos të jesh dorështrënguar dhe mos ha bukë tinëzisht. Të jesh i mëshirshëm dhe dorëdhanës kundrejt ma të rinjve e atyne që gjenden nën mastrimin tënd.

IX

Mos ha bukë para t'unshmit. Nepi dhe ushqeje të unshmin. Ruaju ngatërresavet të grave. Largoju dhe ruaju madhshtis dhe njerëzve madhështorë.

X

Ruaje gjanë e huej. Mos lësho gjithkënd në shtëpi. Mos ndërhyt në mes të burrit e të gruas. Mos i beso gjithkujt. Njife të vërtetën prej kujtdo që ta dëgjosh.

XI

Thuaj të vërtetën edhe në qoftë e idhët. Mos i ban askujt padrejtësi. Mbaje fjalën e kryeje premtimin. Mos jeto n'armiçsi me njerëzit e shtetit. Jeto në paqe e miqësi me fqinjët.

XII

Të jesh mikpritës dhe sillu mirë ndaj tyre. Mos të kesh askënd smirë. Ndero prindin. Mos shko pa u ftue. Ndhmo gjithkënd në qofsh se mundesh.

XIII

Ai që marrohet nga mësimi nuk është njeri. Shtëtimi i njeriut sigurohet me gjuhë. Fjala e thanun nuk kthehet. Çdo e mirë vjen prej së vërtetës.

XIV

Mos e mëso gjuhën me fjalë të dobëta e të padijshme. Mos dëgjo biseda të dobëta. Mos padit askënd. Mos i fol atij që nuk dëgjon. Çka të thuash bane.

XV

Bashkohu me njerëz të mirë e të ndershëm edhe shkoju ndër vizita. Mos fol çka s'din dhe mos puno çka nuk je i zoti. Kujton Pietetin e të vdekurve, kujto veprat e mira të tyne e mos fol për ndonjë vepër të dobët të tyne.

XVI

Mos gënje. Ruaju rrenës e besë në rrenë. Dije se jeta e ardhshme asht ma e mirë se kjo. Ruaju të drejtës së jetime. Ruaju pleqnisë deri sa të jesh i ri. Përgatitu për pleqni deri sa të jesh i ri.

XVII

Mos i lë punët e dimnit për në verë. Mos përdor bare sa të jesh i shëndoshë. Për shërim sjellju vetëm mjekëve të mirë e të provuem edhe mbaji këshillat e porosit e tyne.

XVIII

Ruaju nakarit (hased). Xhymertija le të jetë zanati yt. Mos e shtrëngo detyrësin. Hiqi vërejtjen mikut kur t'ia shofsh gabimin.

XIX

Mësoji fëmijët ndër zanata. Fshihe gjendjen tande prej mikut dhe armikut. Mos dëgjo të fshehtat e huaja edhe mos i shpall.

XX

Të kesh kujdes për çdo fjalë që flet para gjyqit. Kur ke ma shumë, atëherë ruaje ma tepër. Të jesh i durueshëm dhe mbushu me durim. Mbas vështirësive vjen gëzimi e liria.

XXI

Ruaju dhe kujdesu për miqtë. Dije të madh çdo armik. Druje ma tepër atë armik që të shtiret si mik.

XXII

Kjo botë asht kopshti ku mbjellen farat, pema e të cilave do të korret në atë botë e prandaj çka të mbjellësh ke me korrë. Ma parë studioje e njife mirë njeriun, mandej banu mik me të.

XXIII

Nderoje e kujtoje Zotin. Ruaju prej mëkatit. Punoje secilën punë me emën të Zotit e ke qenë fatlum në të dy jetët.

**Botuar në revistën "Zani i Naltë", nr. 7-8,
qershor-korrik 1930.**



IMAM SAHIT HOXHA

(1898-1976)

Jeta në Mejtepe dhe Medrese

Imam Sahit Islam Hoxha u lind më 15 maj 1898 në fshatin Lajthizë të Pukës. Babai i Sahitit quhej Islam, ndërsa nëna Sut. Nga fëmijët e familjes Hoxha, Sahiti ishte fëmija më i shkathët. Në një moshë shumë të re i ndahet nga jeta babai duke lënë kështu jetim: Sahitin, Bajramin, Fatimen. Një ditë, teksa punonte afër shtëpisë së tij, Sahiti shikon disa bashkëmoshatarë, të cilët udhëtonin drejt Pukës për të ndjekur studimet në Mejtepin e Xhamisë së Kodër Hanit. Sipas djalit të tij Ramadan Hoxha kemi: "Sahiti së bashku me vëllan e tij Bajramin dhe bashkëmoshatarin e tij Shaban Rexhën kan ndjekur Mejtepin e Pukës për rreth 4 vjet." Sipas të dhënave, mësimet e para islame imam Sahit Hoxha po ashtu edhe imam Shaban Rexha i morën nga hoxha i njohur Zenel Hoxha. Në këtë kohë Sahiti mund të këtë qenë rreth 12 vjeç. Përveç Sahit Hoxhës, Shaban Rexhës, Bajram Hoxhës kishte edhe nxënës të tjerë, të cilët ishin shokë me Sahit Hoxhës si: Zenel Aga dhe Shaban Aga, etj.

Pas Mejtepit të Pukës, Sahit Hoxha së bashku me imam Shaban Rexhën vijuan mësimet në Mejtepin e Xhamisë së Kabashit. Ishte rreth 16 vjeç kur imam Sahit Hoxha vendos të ndjekë mësimet islame në Mejtepin e xhamisë Kabash. Në librin "Shaban Rexha Ahmeti, njeriu i Punëve të mira" autori Idriz Ahmetaj shkruan: "...Tek po flisnin një ditë me Sahit Islamin (Hoxha), një bashkëmoshatar që ishte pak më i madh, Shabani mësoi së në Kabash ishte hapur Mejtepi." Po ashtu këtu përmendet se: "Unë (thotë Shabani) sot jam gati 16 vjeç dhe po mbetem pa shkollë." Në fakt, familjarët e Sahitit, por edhe të Shabanit e kishin të vështirë lejen për të ndjekur mësimet në Mejtepin e Kabashit, pasi ato duke e ditur se fshati Lajthizë me fshatin Kabash ishin shumë larg nga njëri-tjetri dhe, për më tepër, duhesh kaluar lumi i Gominës, i cili ishte shumë i rrezikshëm gjatë dimrit. Pavarësisht kësaj, Sahit Hoxha vendosi të ndjekë studimet në Mejtepin e Kabashit. Sipas të dhënave, Sahiti së bashku me bashkëmoshatarin e tij Shabanin u regjistruan në Mejtepin e Kabashit rreth

vitet 1916. Aty Sahiti ndoqi mësimet për rreth 4 vjet për të vazhduar me pas studimet në Medresen e Shkodrës. Sipas një të dhëne tjetër kemi se: "Sahit Hoxha ka ndjekur për 3 vite mësimet islame në Mejtepin e Kabashit." Si rezultat i varfërisë së madhe që kishte familja e Sahitit, ai pothuajse rrezikoi me mos ndjekjen e studimeve në Medresen e Shkodrës. Sipas prof. Xhemal Meçi kemi se: "Ishte interesimi i imam Sadik Prishtinës, që Sahit Hoxha të vazhdonte Medresen e Shkodrës". Sipas djalit të Sahitit, Ramadan Hoxha, ishte mirësia e Zotit që Sahiti të takohej me një njeri shumë të mirë i quajtur Man Tepelia. "Dëshira për ta vazhduar (Medresen) ishte aq e madhe sa që filloi të shkonte në mësim pa ngrënë. Duke ecur, i bie të fiket prej urie. Kalimtarët e ndihmojnë të ngrihet. Tregtari bamirës Man Tepelia i siguron bursën.." Me ndihmën tete vjeçare të Man Tepelis imam Sahit Hoxha përfundoi me sukses Medresen e Shkodrës.

Jeta në Shkodër dhe në Pukë

Pasi përfundoj me sukses Medresen e Shkodrës, Sahiti u emërua imam në Xhaminë e Drishtit. Gjatë qëndrimit si imam në këtë xhami ai u njoh edhe me Hafiz Sabri Koçin. Sipas të dhënave ai shërbeu aty si imam për rreth dy vjet. Nga viti 1936 deri në vitin 1937, Sahit Hoxha shërbeu si imam në xhaminë Mes Myselim. Sipas të afërmeve të Sahitit, ai është martuar tre herë, martesë e fundit është e vitit 1939 me Misiren. Nga martesë me Misiren, Sahiti ka këta fëmijë: Naxhijen (martuar në fshatin Meçe me Xhemal Kopani), Aliun (martuar me vajzën e Aleko Manthos nga Gjirokastra), Isën (martuar me vajzën e Sadik Izlami nga fshati Micoj), Farijen (martuar në Laçaj me Asllan Laçi), Muradijen (martuar në Laçaj me Abaz Laçi), Ramadanin (martuar me vajzën e Ibrahim Ukës nga fshati Shikaj Kukës). Rreth vitit 1938, Sahit Hoxha shërbeu si imam në xhaminë e fshatit Micoj. Pas fshatit Micoj, imam kalon në xhaminë e fshatit Vaspas të Kukësit, ku shërben nga viti 1939 deri në vitin 1940. Familjarët e tij tregojnë se ai ka shërbyer si imam edhe në xhaminë e fshatit Kabash të Pukës, por edhe në vende të tjera por kjo me kohë më të kufizuar, si për shembull gjatë muajit Ramazan. Ndërsa sipas prof. Xhemal Meçit kemi: " Sahit Hoxha ka shërbyer në fshatin Kabash për rreth 26 vjet nga viti 1941 - 1967". Gjatë kësaj kohe imam Sahit Hoxha ka qenë edhe Anëtar i Këshillit të Myftinisë Pukë. Ai ka shërbyer si imam përkrah imamëve Elez Hoxha, Qazim Nushi, Shaban Rexha e Beqir Laçi. Kishte raste kur këta imamë bashkoheshin dhe këndonin Mevlud, dua, salavate, sidomos në muajin e Ramazanit. Këtë imam Sahiti e ka bërë kryesisht në fshatrat: Lajthizë, Kabash dhe Meçe. Sipas të dhënave në fshatin Lajthizë Sahit Hoxha së bashku me Shaban Rexhën kanë kryer shërbime fetare në disa shtëpi. Ramadan Hoxha thotë: "Babai im kryer shërbime në disa shtëpi të fshatit tim. Kishte raste që babai im shkonte bashke me imam Shaban Rexhën." Po ashtu djali i tij Ramadan Hoxha tregon: "Për të kryer

shërbime fetare, Sahiti shkonte në shumë shtëpi të fshatit Kabash. Kujtoj që shtëpitë myslimane të Kabashit kishin drekën dhe darkën e caktuar në respekt të Hoxhës." Të njëjtën gjë kemi edhe në fshatin Meçe, ku ai qëndronte te miqtë e tij si: Furrikajt si fisi Kopani. Përveç shtëpisë së Ahmet Isen Kopanit, ai ka qëndruar duke kënduar Kur'an, salavate edhe Mevlud edhe te shtëpia e Jemin Kopanit", Niman Avdis dhe te shtëpia e Jah Met Krovës dhe Zyber Llukës.

Përballja me sistemin komunist

Gjatë jetës së tij imam Sahit Hoxha mbahet mend si njeri punëtor, atdhetar dhe që ishte çdo herë në shërbim të njerëzve për besim dhe liri. Këtu mund të përmendim faktin se gjatë luftës Nacional Çlirimtare shtëpia e tij ka qenë bazë e strehimit të ushtrisë partizane. Sipas Ramadan Hoxhës, kemi: "Në shtëpinë tonë janë strehuar ushtarët partizanë si: Nuri Allazani, Shefqet Peçi, Ali Bytyçi etj.". Sipas djalit të tij Ramadan Hoxha, në vitin 1951, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e ka dërguar si të deleguar në Këshillin e quajtur si "Këshilli i Gjan". Imam Sahiti, duke shikuar përplasjet që filloi të krijohet sistemi komunist, sidomos gjatë viteve 1960-1963, vendosi të mos përfshihej më në lëvizjet politike të asaj kohe, madje filloi të dalë kundër. Arsyeja ishte feja. Në vitin 1966, sistemi komunist vendos të heqë fenë. Kësaj furtune anti-fetare nuk i shpëtoi as imam Sahit Hoxha. Me urdhër të Sekretarit të Parë të Partisë në Pukë u vendos të kontrollohet shtëpia e tij. "Mbah mend ishte natë e Bajramit të madh, kur shtëpia rrethohet nga forcat e policisë. Pasi bënë kontroll, efektivet nuk arritën të gjejnë asnjë gjë kopromentuese përveç librave islamë që babai studioje. Atë natë babain e arrestojnë dhe e marrin me vete... Në fakt ky veprim u bë me qëllim që të nesërmen të mos falej namazi i Bajramit të madh. Vjuan hetimet për tre ditë, por më kot, pasi nuk arritën të gjejnë gjë dhe kështu ditën e tretë e liruan me kusht që të mos dalë ma në rrugë me uniformën e klerikut islam si: çallma, xhybja etj." Me ndalimin e fesë, imam Sahit Hoxha u vetmuar duke përjetuar keq ndalimin e besimit në Zot nga sistemi komunist, i cili tashmë kishte mbyllur të gjitha xhamitë e Pukës dhe të gjithë Shqipërisë.

Në moshën 78 vjeçare, saktësisht më 16 tetor 1976, imam Sahit Hoxha ia dorëzoi shpirtin Krijuesit të Gjithësisë, duke lënë pas kontributin e tij në ngritjen dhe përhapjen e fesë islame në rrethin e Pukës.

Në vitin 2016, Myftinia Pukë përkujtoi 25 vjetorin e riorganizimit të saj. Me këtë rast përkujtimor Këshilli i Myftinisë Pukë vlerësoi disa hoxhallarë, mes të cilëve edhe imam Sahit Hoxhën, me certifikatë "Mirënjohje" pas vdekjes, me këtë motivacion: "Për kontributin e dhënë përgjatë një dekade si imam në Xhaminë e fshatit Kabash Pukë, Pistë etj."

MORINGA NJË BURIM SHËRIMI



Megjithëse është një pemë indiane, moringa rritet gjithashtu në vendet tropikale, siç është Nigeria. Gjethet e saj janë ngrënë ose pjekur prej kohësh për përfitime shëndetësore, por efektiviteti i saj ende nuk është i njohur në pjesë të tjera të botës. Shpesh e quajtur "bima e mrekullive", mbi moringën janë bërë një sasi e konsiderueshme hulumtimesh për vetitë e saj terapeutike dhe këto hulumtime shpresojnë të përhapin njohuri për vetitë e saj shëruese.

Literatura përmend veçoritë e saj antioksiduese, antikancerogjene, anti-inflamatore, antidiabetike dhe antimikrobale. Gjethet e saj përmbajnë proteina me cilësi të lartë dhe farat kanë lipide (yndyrë) me bollëk. Kjo është arsyeja pse moringa ka një sasi të madhe të kalciumit, kaliumit, natriumit dhe hekurit. Pretendohet se moringa ka dymbëdhjetë herë më shumë vitaminë C sesa portokallet, dhjetë herë më shumë vitaminë A sesa karotat, shtatëmbëdhjetë herë më shumë kalcium sesa qumështi, nëntë herë më shumë proteina sesa kosi, dhe njëzet e pesë herë më shumë hekur se spinaqi.

Moringa përdoret për të trajtuar më shumë se 300 sëmundje, veçanërisht në Afrikë. Egjiptianët e lashtë e kanë përdorur atë si krem për lëkurën. Që atëherë, gjithnjë e më shumë përfitimet e saj kozmetike janë zbuluar dhe ajo ka gjetur një vend unik midis produkteve të kujdesit shëndetësor sot. Moringa përdoret për të përshpejtuar rritjen e flokëve, trajtimin e sëmundjeve të tilla si yndyra e tepërt e flokëve, zbokthi dhe inflamacioni i lëkurës së kokës, trajtimi i rrudhave të lëkurës, pikat e zeza dhe puçrrat në lëkurë dhe për të menaxhuar ekzemën dhe psoriasis. Për të përcaktuar efektivitetin përfundimtar të bimës, nevojiten më shumë hulumtime dhe punë laboratorike.

Pas nxjerrjes së vajit, farat dhe mbetjet e moringës përdoren si një pleh organik që rrit efikasitetin e bujqësisë. Farat, gjethet, vaji, lëkura, rrënjët dhe lulet përdoren gjithashtu për gatim dhe trajtim. Gjethet e bimës mund të përdoren si çaj dhe mund të hahen të papërpunuara si perimet në sallatë.

Më shumë se 400 studime të kryera gjatë shumë viteve kanë shqyrtuar efektet e moringës në sëmundjet e ndryshme. Gjetjet domethënëse mund të përmbliken si vijon: Është treguar se redukton fuqimisht kolesterolin dhe yndyrnat e gjakut, si dhe pllakat aterosklerotike. Ky efekt madje mund të arrihet me konsumin oral të bimës. Kur zhvishet, lëvozhga e frutave moringa zbulon një farë të butë të bardhë, si një copë pambuk me madhësinë e arrës. Fara mund të konsumohet duke e gëlltimitur atë. Rrënjët dhe degët e moringës mund të thërrmohen dhe të përdoren si pluhur.

Studimet kanë zbuluar gjithashtu se përdorimi i moringës mund të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të shumta, duke përfshirë infeksione të mëlçisë siç është hepatiti, duke ulur nivelet e glukozës në gjak të pacientëve me Diabet Tip-2, probleme të ndryshme gastrointestinale, rritjen e prodhimit të qumështit te nënat që ushqejnë fëmijën me gji, rregullimin e funksioneve të veshkave, sëmundjen e Parkinsonit dhe dermatitin atopik.

Disa nga studimet e kryera shqyrtojnë se sa është e sigurt moringa. Njerëzit kanë një prirje të përgjithshme ndaj konsumimit të bimëve natyrore pa i kushtuar vëmendje sesa konsumojnë. Fatkeqësisht, ka shumë bimë kërcënuese për jetën dhe bimë të tjera që mund të jenë të rrezikshme kur merren në sasi të mëdha. Në përpjekje për të identifikuar gamën e sigurisë së moringës, një studim që zgjati 14 ditë shqyrtoi efektet e saj te minjtë që kishin depresion dhe përdornin anti-depresivë. Studiuesit zbuluan se moringa nuk shkakton toksicitet, me kusht që doza të mos kalojë 2 gramë për 2.2 paund peshë. Do të ishte e mençur ta shfrytëzonim këtë bimë pasi të ketë përfunduar procesi i testimit te njerëzit dhe të përgatitet një udhëzues për të treguar llojet e sëmundjeve dhe dozat përkatëse të përdorimit.

Sëmundjet janë një fakt i jetës. Fatmirësisht, universi është i pasur me bimë si moringa, të cilat mund të përdoren për të lehtësuar dhimbjet dhe sëmundjet tona. I detyrohemi vetvetes dhe njerëzve të tjerë, të studiojnë të gjitha aspektet e universit, përfshirë edhe bimën moringa.

SHPESHTËSIA E TË NGRËNIT dhe shembulli i profetit Muhamed (a.s.)

Në kulturën moderne pranohet gjerësisht se njerëzit duhet të hanë tre vakte: mëngjes, drekë dhe darkë. Nutricionistët zakonisht rekomandojnë të shtohen edhe dy vakte të ndërmjetëm (njëri paradite dhe tjetri pasdite) për të ndihmuar në kontrollin e oreksit.

Është interesante se praktika e të ngrënit tre vakte në ditë është një fenomen i kohëve të fundit. Romakët e lashtë kishin vetëm një vakt, të cilin zakonisht e kishin në orën katër pasdite, dhe besonin se ishte e pashëndetshme të hanin më shumë se një herë në ditë. Ajo që hanin romakët në mëngjes dhe në mesditë ishte diçka shumë e lehtë dhe e shpejtë. Më vonë, rregullat në manastire ndikuan në sjelljen e njerëzve rreth ushqimit dhe pijeve.

Gjatë revolucionit industrial, mëngjesi fitoi rëndësi, sepse punëtorëve u duhej ushqim para punës, ndërsa darka nuk ishte e popullarizuar, të paktën në formën e saj të tanishme, derisa mbizotërimi i ndriçimit artificial bëri të mundur ngrënien para agimit dhe pas muzgut. Të kuptuarit se të hash tre vakte në ditë është një zgjedhje e shëndetshme buron nga një kombinim i besimit, kulturës dhe studimeve të hershme epidemiologjike.

Ka studime që sugjerojnë se të kesh një zakon të rregullt të ngrënies ndikon pozitivisht në shëndet, pavarësisht nga shpeshësia e vakteve. Nga ana tjetër, në një studim të kohëve të fundit dhe gjithëpërfshirës nga Kahleova et al., i cili studioi 50.660 anëtarë të rritur të kishave në ShBA dhe Kanada, u zbulua se ngrënia e një ose dy vakteve në ditë shkaktonte peshë më të ulët sesa ngrënia e tre vakteve dhe gjithashtu një indeks relativisht më të ulët të masës trupore (BMI,) i cili u bë edhe më i ulët pasi koha pa ngrënë gjatë natës u zgjat më shumë. Autorët shprehen se efektet pozitive të një diete të tillë janë shkaktuar nga një kombinim i kohës, frekuencës së vaktit dhe qëndrimit pa ngrënë gjatë natës, si dhe nga ushqimi më pak i shpeshtë shoqëruar me kohën e saktë të marrjes. Këto rezultate tregojnë se të hash një ose dy vakte është më mirë sesa të hash tre ose më shumë.

Shembulli i Profetit Muhamed a.s.

Këshillat dhe sjelljet e Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi të, i japin mbështetje studimeve moderne mjekësore në fushën e të ushqyerit, si në shumë të tjera. Ai hante jo më shumë se dy vakte dhe sigurohej që njëri nga vaktet duhet të përbëhej nga ushqim i lehtë (siç janë hurmat). Profeti ka këshilluar që darka të hahet, edhe nëse do të ishte vetëm një vakt i vogël. "Mos e lini darkën, edhe nëse është vetëm me një grusht hurmash, sepse braktisja e saj ju bën të dobët" (Sunen Ibn Maxheh).

Ai e përcaktoi darkën si vaktin e dytë dhe të fundit të ditës dhe se ajo duhet të hahet pas muzgut ose menjëherë pas namazit të mbrëmjes.

Profeti a.s. ka dhënë kaq shumë shembuj në lidhje

me ushqimin. Ai ka theksuar rreziqet e mbipeshës, duke thënë: "Ajo që kam frikë më shumë për komunitetin(bashkësinë) tim(e) është vënia e barkut, gjumi i tepërt dhe fjalët boshe". Kjo është thënë shekuj më parë, por në ditët e sotme, mbipeshja është një epidemi që po përhapet në të gjithë botën dhe incidenca e saj pothuajse është dyfishuar në më shumë se 70 vende që nga viti 1980. Në vitin 2015, gjithsej 107.7 milion fëmijë dhe 603.7 milion të rritur ishin obezë. 75 për qind e popullsisë në botë është mbipeshë. Obeziteti, së bashku me dislipideminë dhe hipertensionin, është një nga faktorët kryesorë në sëmundjet kardiovaskulare. Studimet kanë treguar që ushtrimet, si dhe koha e vaktit dhe frekuenca, janë mjaft efektive në kontrollin e peshës.


Sa për mënyrat e të ngrënit, Profeti a.s. ka thënë: "Njeriu nuk mbush asnjë enë më të keqe se stomaku i tij", dhe "është e mjaftueshme që biri i Ademit të hajë aq sa për të mbajtur kurrizin drejtë". Gjatë gjithë jetës 63-vjeçare të tij, Profeti a.s. kurrë nuk u ngrit me stomakun plot ose të ketë ngrënë para se të kishte uri. Ai ka këshilluar që ushqimi të mos gëlltitet pa u përthypur mirë, një praktikë që ai e ka mbajtur. Duke refuzuar të ulet në tavolina ku kishte disa lloje ushqimesh, Profeti ynë herë pas here nuk ishte në gjendje të gjente asgjë për të ngrënë. Nuk ka gjithashtu asnjë informacion që Profeti ynë të ketë ngrënë ndonjëherë drekë.

Këmbëngulja e Profetit a.s. për më pak ushqime duket shumë e mençur. Jo vetëm të ngrënit pak ushqim çon në incidencë më të ulët të obezitetit, nëse përfshin një zvogëlim të konsumit të karbohidrateve, por ai gjithashtu mund të çojë në ulje të nivelit të LDL (kolesterolit të dëmshëm). Në përgjithësi, konsumuesit e mëngjesit kanë tendencë të rrezikojnë më pak për shtimin e peshës sesa ata që nuk konsumojnë mëngjes dhe një rrezik dukshëm më të ulët të sëmundjeve të zemrës.

Studimet e fundit tregojnë se përmbajtja e ushqimit ka po aq ndikim në lipidet e gjakut dhe insulinën sa edhe frekuenca e vakteve. Edhe pse ne nuk mund të shpjegojmë plotësisht efektet e një faktori të vetëm në shëndetin fizik, ne jemi shumë të sigurt që frekuencat e vakteve janë të lidhura ngushtë me kohën e vaktit dhe llojet e ushqimeve që konsumohen.

Kërkesa kryesore e Profetit a.s. për ushqim ishte që ajo të jetë hallall dhe e pastër, si dhe e dobishme për trupin. Dy vaktet e tij konsistojnë në mëngjes dhe darkë, siç rekomandohet nga mjekësia moderne. Me pak fjalë, këshillat e marrjes dhe sasisë së ushqimit të rekomanduar nga Profeti ynë është ndarja e "një të tretës së stomakut për ushqim, një të tretën për pije dhe një të tretën për ajër" (Tirmidhi, Zuhd, 47) dhe të mbarojnë vaktin pa u ngopur. Shkenca gjithnjë e më tepër po provon se kjo është një këshillë tepër e vyer.

Një martesë e shëndetshme *një investim i çmuar*



Të ruash ekuilibrin brenda familjes, të ruash shëndetin e saj është një pikë shumë e rëndësishme. Ruajtja e ekuilibrave të caktuar sigurisht që kërkon angazhimin e të gjithë anëtarëve të familjes. Ky angazhim duhet të jetë si në kohët e shëndetshme ashtu edhe në kohët e krizës në mënyrë që të ruhet struktura familjare dhe vazhdimësia e saj.

Disa periudha të rëndësishme në martesë

Periudha para martesë: në këtë periudhë e cila sipas kulturës sonë quhet edhe si fejesë të dy palët bashkë me familjet e tyre përpiqen të njohin njëri tjetrin. Problemet më kryesore gjithnjë e kanë bazën në familje. Problemet ku hasin familjet e çiftit pasqyrohen edhe tek marrëdhënia e çiftit të ri. P.sh., nëse të rinjtë e sapo fejuar i përkasin kulturave të ndryshme mund të lindin vështirësi, përplasje, pakënaqësi ndërkohë që në raste të tjera kjo larmi kulturash mund të vlerësohej si diçka pozitive.

Periudha e martesës: çiftet tani fillojnë të pasqyrojnë modele të tjera sjelljeje. Ngaqë koha e kaluar së bashku është më e gjatë, fillojnë të pasqyrojnë vetveten dhe sjelljen e tyre reale. Në disa raste sjelljet e vërteta të partnerit mund të sjellin një sinqeritet më të thellë e në disa raste mund të sjellin zhgënjime të mëdha

Ardhja e një anëtari të ri në familje: një nga situatat të cilat ndikojnë më shumë në martesë është marrja e lajmit të ardhjes së një fëmije. Gjendja e ndryshueshme emocionale e femrave gjatë shtatzanisë kërkon domosdoshmërisht mbështetjen dhe ngrohtësinë e bashkëshortit. Gjatë kësaj periudhe vihet re një zgjerim në rolet e bashkëshortëve, të dy tashmë bëhen gati të jenë prindër. Prindërit e çiftit bëhen gati të bëhen gjyshër, pra rolet ndryshojnë. Ndryshimi i roleve në disa familje bëhet burim gëzimi e kënaqësie e në disa familje të tjera shndërrohet në burim shqetësimi, ankthi e stresi. Në këta raste nëna nuk duhet lënë vetëm në muajt e parë pas sjelljes në jetë të fëmijës. Mbështetësit më të mirë mund të jenë bashkëshorti dhe nëna e saj. Të gjitha shqetësimet e përjetuara nga anëtarët e tjerë të familjes nuk duhet t'i transmetohen nënës së re sepse ndikon thellësisht në gjendjen e saj emocionale.

Rritja e fëmijëve: me rritjen e fëmijëve ndryshojnë edhe marrëdhëniet brenda familjes. Adoleshenca, kërkimi i vetvetes, problemet e brendshme, përbëjnë disa nga problemet e familjes së kësaj periudhe. Ndërkohë që fëmijët rriten dhe kërkojnë të marrin iniciativë të pavarura, ka prindër

që nuk arrijnë të pranojnë rritjen e fëmijës dhe nuk i lënë të bëjnë zgjedhjet e tyre të pavarura.

Periudha e moshës së mesme: në këtë periudhë vihet re një lloj ndryshimi në marrëdhëniet brenda familjes. Njeriu fillon të shohë më shumë veten, të pyesë veten nëse është apo jo aty ku ka dashur të jetë, nëse i ka arritur apo jo qëllimet .

Pleqëria: është periudha kur fëmijët largohen nga familja, krijojnë familjet e tyre dhe bashkëshortët mbeten vetëm. Bashkë me plakjen fillojnë të pakësohen dhe fuqitë fizike, aftësitë motorike të individit.

Vdekja: vdekja të rikujton edhe një herë qëllimin e ardhjes në këtë jetë, qëllimin e ekzistencës tënde. Vdekja e njërit nga bashkëshortët ndikon më tepër tek bashkëshorti tjetër që mbetet vetëm. Në këtë rast bashkëshorti i mbetur vetëm duhet të mbështetet nga fëmijët dhe nëse nuk ka fëmijë, nga të afërmit e tij.

Çfarë duhet bërë për një investim të mirë martesor:

Lidhja: krijimi i një lidhjeje të fortë e të qëndrueshme sigurisht që mbështetet në besim e siguri. Besimi ushqen dashurinë dhe forcon lidhjen.

Vlerëso marrëdhënien: vlerëso partnerin/ en, lavdëroje, mos e kritikoj, bëje të ndihet i/e dashuruar dhe ç'është më e rëndësishmja shprehe me fjalë dashurinë dhe vlerësimin tënd.

Kaloni kohë sëbashku: kalimi i kohës bashkë, zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta dhe zbatimja së bashku forcon marrëdhënien bashkëshortore.

Qëndrimi i mbajtur gjatë momenteve të krizës: mbështetja e njëri-tjetrit gjatë momenteve të vështira në jetë forcon më mirë themelin e martesës.

Mbështetja dhe stimulimi: në rastet kur njëri nga bashkëshortët nuk ndihet i mjaftueshëm, pala tjetër duhet të luajë rolin e mbështetësit, nxitësit në mënyrë që të vazhdohet përpara.

Të mbajmë rolet që na përkasin: në jetë kemi më shumë se një rol. Kur martohemi na shtohen edhe më shumë. Me kalimin e kohës mund të përballemi me një rrëmujë rolesh. Bashkëshortët duhet të sillen në përshtatje me rolet e tyre në mënyrë që të mos ketë përplasje të forta.

Të komunikosh shëndetshëm: për të realizuar një komunikim të shëndetshëm pikë së pari duhet të mësojmë të shprehim ndjenjat tona. Kjo është e domosdoshme nëse duam një martesë të konsoliduar.

Nga Aisa Kokiçi

PLAKU

thinjosh...

Aq i qetë është sa ndonjëherë kthehet edhe në bezdisje për ata që nuk janë mësuar të durojnë! I moshuar e midis thinjash, që duket se secila prej tyre numëron ndonjë ditë të gjatë jete, plaku i mirë Ali mbetet megjithatë një njeri i zakonshëm për ata që nuk e vënë re. Ditët e tij të pleqërisë rrjedhin midis librash, aq sa duket si një akademik në mes të karrierës. Ai është vetëm një tregtar, por, mbi të gjitha, një besimtar, një mysliman i mirë. Gjithherë i qetë e në harmoni me fytyrën e paqtë, duket si një njeri i zhytur në vetminë e tij i ngujuar në dyert e shtëpive të Zotit. Në fakt, ai jeton midis njerëzish dhe aty mbush ditët e tij, sigurisht me paqe e midis shkronjash të arta të Kuranit. Në atë fllad të gjatë durimi, ai kurrë nuk nervozohet dhe duket si një pemë e heshtur në një pyll të dendur. Sikur të gjithë njerëzit të ishin si ai!

Plaku thinjosh e i mirë Ali jeton jo shumë larg

Tiranës. E gjithë familja e tij është besimtare dhe ai duket si kurorë e artë në atë oaz besimi. Ajo freski i ka kapluar të gjithë ata njerëz dhe si të tillë janë heronj të heshtur në gjurulldinë e këtij qyteti të zhurmshëm. Nëse ke sy, mund t'i pikasësh, por, mbi të gjitha, nëse ke zemër aq të bardhë, mund t'i kuptosh, por për të kuptuar më mirë plakun e paqtë Ali, duhet të kesh mendje sqimatore.

Ai nuk tregon, as nuk flet, ai vetëm dëshmon, me gjestet e tij, me sjelljen, me heshtjen dhe pastërtinë e shpirtit. Dhe si jo të gjithë tregtarët e tjerë, kujdeset që gjithmonë peshorja të anojë nga blerësit, si për të treguar se ka ndërmend që për vete të ketë një peshore shpirti. Çdo herë kur bën një porosi, ai të jep më tepër e çdo pesë lule që mund të blesh, e gjashta është dhuratë. Ai ka vendosur që të mbjellë për vete të tjera, të tjera kopshte, në xhenet shpreson.



Gënjeshtra as që ekziston për plakun thinjosh, e kur flet, flet rrallë, por me peshë. Kështu është edhe me biznesin e tij. Është gjithmonë i gatshëm të tregojë mangësitë e mallit, edhe atëherë kur kjo bie ndesh me atë çka synon: sa më shumë shitje. Por, plakuri i mirë Ali bën të tjera llogari e kërkon të tjera bilance për veten. Ai lëshon dorën në tokë, duke pritur lëshimin e sevapeve nga qielli. Ai nuk pret nga askush, as nuk e tepron dhe as nuk kërkon. Fiks, ai ka arritur pikën e harmonisë me veten e me botën dhe sigurisht edhe me Zotin dhe është pikërisht arritja e kësaj pike që i jep njeriut një ekuilibër të shkëlqyer. Për ta arritur duhet të kesh zemër të madhe, dorë të lirë, shpirt të bardhë. Plaku Ali është i tillë dhe i tillë do të jetë sa kohë do t'ia dorëzojë shpirtin Zotit. Një shembull nga ata të rrallët, nga ata që nuk shihen çdo ditë, por që të frymëzojnë

nëse e pikas, nëse e studion dhe e vëzhgon me vëmendje.

Pas tij vjen bashkëshortja e tij, e cila e ndjek po ashtu në atë rrugë të mirë. E qetë dhe e qeshur, si gjithmonë ka një urim, një bekim për të dhënë, e si gjithmonë nuk harron që një fidan të jetë i tepërt për të gjithë ata që blejnë. Kur e pyet, kurrë nuk thotë se të bëri nder, as nuk ta kujton e madje as nuk ta tregon kur nuk e vë re. Si gjithnjë llogaria është tjetërkund. Çdo herë kujton vdekjen si forcë ndalese për kah e keqja dhe kështu bën edhe një të mirë më tepër.

Midis këtyre të mirave, të dy, burrë e grua, rrojnë në qetësi. Janë të pasur, por pasurinë më të madhe, siç thonë, kanë besimin në Zot e për këtë nuk rreshtin si falënderuari Zotin.

Saimir Lleshi



INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME
"H. Sabri Koçi"

FILLUAN REGJISTRIMET PER VITIN AKADEMIK 2023-2024

KURAN
HADITH
TEFSIR
FIKH
HISTORI ISLAME
MORALI ISLAM
HITABET

INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI" ËSHTË NJË NISËM E KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË DHE KA PËR QËLLIM OFRIMIN E NJOHURIVE FETARE PËR ÇDO TË INTERESUAR DHE PËR PËRMIRËSIMIN E NJOHURIVE TË KUADROVE NËPËR MYFTINI.

MËSIMI ZHVILLOHET ONLINE DHE FIZIKISHT NË AMBIENTET E KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR".

MUJI SHTATOR ËSHTË I HAPUR PËR REGJISTRIME PËR FEMRA DHE MESHKUJ
TË MOSHAVE 15 DERI NË 45.

PËR MË SHUMË INFORMACION KONTAKTONI **069 123 456 7896** OSE PRANË ÇDO MYFTINIE

